

**Bankers Petroleum Albania Ltd**  
**Dega në Shqipëri**

**Pasqyrat Financiare**  
**më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

**(me raportin e Audituesve të Pavarur bashkëngjitur)**

## **Përmbajtja**

	Faqe
Raporti i Audituesve të Pavarur	i - ii
Pasqyrat financiare	
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse	1
Pasqyra e pozicionit financiar	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e flukseve monetare	4
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare	5 – 32



**KPMG Albania Shpk**  
"Dëshmorët e Kombit" Blvd  
Twin Towers Buildings  
Building 1, 13th floor  
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524  
+355(4)2274 534  
Telefax +355(4)2235 534  
E-mail al-office@kpmg.com  
Internet www.kpmg.al

## Raporti i audituesve të pavarur

Pronarit dhe drejtimin të  
Bankers Petroleum Albania Ltd. – Dega në Shqipëri

Tiranë, 18 prill 2016

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Bankers Petroleum Albania Ltd. – Dega në Shqipëri ("Dega"), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015, pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, ndryshimeve në kapital dhe flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese

### *Përgjegjësia e Drejtimin për Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

### *Përgjegjësia e Audituesve*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

### *Opinionin*

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të sinqertë, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të Degës më 31 dhjetor 2015, rezultatit e saj financiar dhe flukset e saj monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.


### *Informacioni Krahasues*

Pa dhënë rezervë për opinionin tonë, ne tërheqim vëmendjen në shënimin 30 të pasqyrave financiare që tregojnë se informacioni krahasues i paraqitur më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur.

Pasqyrat financiare të Degës më dhe për vitet e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013 (nga e cila rrjedh pasqyra e pozicionit financiar më 1 janar 2014), duke përjashtuar korrigjimet dhe riklasifikimet e përshkruara në shënimin 30 të pasqyrave financiare, janë audituar nga një tjetër auditues i cili ka shprehur një opinion pa rezervë mbi këto pasqyra financiare më 27 maj 2015.

Si pjesë e auditimit tonë të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015, ne audituam korrigjimet dhe riklasifikimet e përshkruara në shënimin 30 që ishin zbatuar në riparaqitjen e informacionit krahasues të paraqitur më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe pasqyrën e pozicionit financiar më 1 janar 2014. Ne nuk ishim të angazhuar për auditimin, rishikimin apo kryerjen e ndonjë procedure mbi pasqyrat financiare për vitet e mbyllur më 31 dhjetor 2014 ose 31 dhjetor 2013 (jo të paraqitur këtu) apo mbi pasqyrën e pozicionit financiar më 1 janar 2014, përveç se në lidhje me korrigjimet dhe riklasifikimet e përshkruara në shënimin 30 të pasqyrave financiare. Për këtë arsye, ne nuk shprehim një opinion apo ndonjë formë tjetër të dhënies së sigurisë mbi ato pasqyra financiare të marra përkatësisht si një e tërë. Megjithatë, në opinionin tonë, korrigjimet dhe riklasifikimet e përshkruar në shënimin 30 janë të përshtatshme dhe janë zbatuar në rregull.

Fatos Beqja  
*Auditues Ligjor*



KPMG Albania Shpk  
“Deshmoret e Kombit” Blvd.  
Twin Towers Buildings  
Building 1, 13th floor  
Tirana, Albania

**Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri**  
**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave përmbledhëse për vitin e mbyllur 31 Dhjetor**  
*(Shumat janë në mijë Lekë)*

	Shënime	2015	2014 Riparaqitur
Të ardhurat		36,025,178	61,497,730
Pagesa për të drejta minerare		(5,044,101)	(9,051,600)
Të ardhura neto	8	<b>30,981,077</b>	<b>52,446,130</b>
Shpenzime operative	9	(10,579,159)	(10,016,021)
Shpenzime të shitjes dhe transportit	10	(4,885,162)	(6,272,094)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	11	(1,393,935)	(1,437,705)
Shpenzime për zgjidhje kontrate	12	(48,495)	(2,105,183)
Amortizimi dhe harxhimi	20,21	(14,992,927)	(12,240,708)
Pagesa bazuar në aksione	13	(212,966)	(194,747)
(Shpenzime)/rimarrje zhvlerësimi	7 (a)	(2,047,732)	1,210,293
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(34,266,453)</b>	<b>(31,056,165)</b>
<b>(Humbja)/fitimi operativ</b>		<b>(3,285,376)</b>	<b>21,389,965</b>
Shpenzime financiare neto	14	(1,426,160)	(1,231,263)
<b>(Humbja)/fitimi përpara tatimit</b>		<b>(4,711,536)</b>	<b>20,158,702</b>
Përfitimi/(shpenzimi) i tatimit mbi fitimin	15	2,723,507	(9,197,118)
<b>(Humbja)/fitimi</b>		<b>(1,988,029)</b>	<b>10,961,584</b>
<b>Të ardhura të tjera përmbledhëse</b>			
Diferenca përkthimi		4,595,836	5,414,576
<b>Të ardhura përmbledhëse të vitit</b>		<b>2,607,807</b>	<b>16,376,160</b>

Shënimet në faqet 5 – 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri**  
**Pasqyra e pozicionit financiar**

(Shumat janë në mijë Lekë)

	Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014	1 janar 2014
			Riparaqitur	Riparaqitur
<b>Aktive</b>				
<b>Aktive afatshkurtra</b>				
Mjete monetare dhe ekuivalentë	16	34,467	561,595	2,322,184
Mjete monetare të ngurtësuara	17	1,719,169	576,150	724,137
Shuma dhe shpenzime të parapaguara	18	8,243,352	7,177,918	4,525,650
Llogari të arkëtueshme e të tjera	19	6,102,857	9,011,031	7,462,270
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	20	85,369	78,203	69,129
Inventarë	21	567,730	1,156,145	3,873,242
		<b>16,752,944</b>	<b>18,561,042</b>	<b>18,976,612</b>
<b>Aktive afatgjata</b>				
Aktive afatgjata materiale	22	127,672,298	113,675,606	82,607,204
Aktive kërkimi dhe vlerësimi	23	1,105,957	986,972	698,312
		<b>128,778,255</b>	<b>114,662,578</b>	<b>83,305,516</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>145,531,199</b>	<b>133,223,620</b>	<b>102,282,128</b>
<b>Detyrimet</b>				
<b>Detyrime Afatshkurtra</b>				
Hua	24	2,120,219	-	1,527,885
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	20	37,910,829	30,101,828	32,250,970
Të pagueshme dhe detyrime të përlogaritura	25	4,345,814	7,120,134	4,045,420
		<b>44,376,862</b>	<b>37,221,962</b>	<b>37,824,275</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>				
Detyrim për nxjerrje nga përdorimi	26	3,416,265	2,840,738	2,301,657
Detyrim për tatimin e shtyrë	15	44,253,299	43,029,763	29,155,592
		<b>47,669,564</b>	<b>45,870,501</b>	<b>31,457,249</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>92,046,426</b>	<b>83,092,463</b>	<b>69,281,524</b>
<b>Kapitali</b>				
Kontribut shtesë		7,290,230	6,544,421	5,790,028
Rezervë përkthimi		9,660,055	5,064,219	(350,357)
Fitim i pashpërndarë		36,534,488	38,522,517	27,560,933
		<b>53,484,773</b>	<b>50,131,157</b>	<b>33,000,604</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>145,531,199</b>	<b>133,223,620</b>	<b>102,282,128</b>

Shënimet në faqet 5 - 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Bankers Petroleum Ltd. – Dega në Shqipëri janë miratuar nga Drejtimi më 15 prill 2016 dhe janë nënshkruar në emër të tij nga:

Suneel Gupta  
Administrator



Ardit Kero  
Drejtor Finance

**Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri**  
**Pasqyra e ndryshimit në kapital**

(Shumat janë në mijë Lekë)

	Kontribut shtesë	Rezervë përkthimi	Fitimi i pashpërndarë	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2014, siç është raportuar më parë</b>	-	-	<b>24,993,386</b>	<b>24,993,386</b>
Ndikimi i korigjimit të gabimeve	5,790,028	(350,357)	2,567,547	<b>8,007,218</b>
<b>Gjendja e riparaqitur më 1 janar 2014</b>	<b>5,790,028</b>	<b>(350,357)</b>	<b>27,560,933</b>	<b>33,000,604</b>
<b>Totali i të ardhurave përmblledhëse</b>				
Diferenca përkthimi	-	5,414,576	-	<b>5,414,576</b>
Fitimi	-	-	10,961,584	<b>10,961,584</b>
<b>Totali i të ardhurave përmblledhëse për vitin (riparaqitur)</b>	<b>5,790,028</b>	<b>5,064,219</b>	<b>38,522,517</b>	<b>49,376,764</b>
<b>Transaksione me pronarët e degës</b>				
<b>Kontribute dhe shpërndarje</b>				
Pagesa bazuar në aksione	754,393	-	-	<b>754,393</b>
<b>Totali i kontributeve dhe shpërndarjeve</b>	<b>754,393</b>	-	-	<b>754,393</b>
<b>Gjendja e riparaqitur më 31 dhjetor 2014</b>	<b>6,544,421</b>	<b>5,064,219</b>	<b>38,522,517</b>	<b>50,131,157</b>
<b>Totali i humbjeve përmblledhëse</b>				
Diferenca përkthimi	-	4,595,836	-	<b>4,595,836</b>
Humbja	-	-	(1,988,029)	<b>(1,988,029)</b>
<b>Totali i humbjes përmblledhëse për vitin</b>	<b>6,544,421</b>	<b>9,660,055</b>	<b>36,534,488</b>	<b>52,738,964</b>
<b>Transaksione me pronarët e degës</b>				
<b>Kontribute dhe shpërndarje</b>				
Pagesa bazuar në aksione	745,809	-	-	745,809
<b>Totali i kontributeve dhe shpërndarjeve</b>	<b>745,809</b>	-	-	<b>745,809</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2015</b>	<b>7,290,230</b>	<b>9,660,055</b>	<b>36,534,488</b>	<b>53,484,773</b>

Shënimet në faqet 5 – 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri**  
**Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor**

(Shumat janë në mijë Lekë)

	Shënime	2015	2014
<b>Flukset monetare nga aktivitetet operative</b>			
(Humbja)/fitimi para tatimit		(4,711,536)	20,158,702
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimi dhe harxhimi	22	14,992,927	12,240,708
Rritje e detyrimit për nxjerrje nga përdorimi	14	153,948	117,459
Shpenzime/(rimarrje) zhvlerësimi	7(b)	2,153,809	(1,210,293)
Pagesa bazuar në aksione	13	212,966	194,747
Të ardhura interesi	14	-	(23,400)
Shpenzime interesi	14	89,180	26,303
		<b>12,891,294</b>	<b>31,504,226</b>
<i>Ndryshime në:</i>			
Mjete monetare të ngurtësuara		(1,091,692)	222,472
Shuma dhe shpenzime të parapaguara		(408,180)	(1,809,009)
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera		1,585,208	614,114
Inventarë		695,306	2,952,573
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura		5,057,210	(5,842,325)
Të pagueshme dhe detyrime të përlllogaritura		(3,431,461)	2,328,486
<b>Flukse monetare nga aktivitetet operative</b>		<b>15,297,685</b>	<b>29,970,537</b>
Interes i arkëtuar		-	23,400
Interes i paguar		(89,180)	(26,303)
<b>Flukse monetare neto nga aktivitetet operative</b>		<b>15,208,505</b>	<b>29,967,634</b>
<b>Flukse monetare nga aktivitet investuese</b>			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale, aktiveve të kërkimit dhe vlerësimit		(17,910,965)	(30,276,084)
<b>Flukse monetare neto të përdorura për aktivitetet investuese</b>		<b>(17,910,965)</b>	<b>(30,276,084)</b>
<b>Flukse monetare nga aktivitetet financuese</b>			
Të hyra/(pagesa) të huave, neto		2,123,084	(1,582,184)
<b>Flukse monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetet financuese</b>		<b>2,123,084</b>	<b>(1,582,184)</b>
<b>Ulje neto në mjete monetare dhe ekuivalentë</b>		<b>(579,376)</b>	<b>(1,890,634)</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentë më 1 janar		561,595	2,322,184
Efekti neto nga përkthimi në monedhë të huaj		52,248	130,045
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë në fund të vitit</b>	<b>16</b>	<b>34,467</b>	<b>561,595</b>

Shënimet në faqet 5 – 32 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



**Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri**  
**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

---

*(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)*

## **1. NJËSIA RAPORTUESE**

Bankers Petroleum Albania Ltd. – Dega në Shqipëri (“Dega”) është krijuar si degë e Bankers Petroleum Albania Ltd. (“Shoqëria mëmë”), një shoqëri e organizuar sipas ligjeve të Ishujve Cayman dhe është e angazhuar në kërkimin dhe prodhimin e naftës në Shqipëri. Mëma është plotësisht në pronësi të Bankers Petroleum International Limited, një shoqëri e themeluar në Jersey dhe e zotëruar 100% nga Bankers Petroleum Ltd (“shoqëria mëmë përfundimtare” ose “Bankers”). Shoqëria mëmë përfundimtare është një shoqëri e themeluar në Kanada dhe e listuar në Bursën e Torontos dhe në Tregun e Investimeve Alternative të Bursës së Londrës nën simbolin BNK.

Dega është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në Shqipëri më 28 korrik 2004.

Dega operon në fushën naftëmbajtëse të Patos-Marinzës në pajtim me Marrëveshjen Hidrokarbure të mëmës me Albpetrol Sha (Albpetrol), shoqëri e naftës e zotëruar nga shteti, nën licencën ekzistuese të Albpetrolit me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN). Marrëveshja e Patos-Marinzës u bë efektive në mars 2004 dhe ka një afat 25 vjeçar me opsionin për t’u zgjatur dhe për pesë vite të tjera, me zgjedhjen e Shoqërisë mëmë, pas miratimit të qeverisë dhe organeve rregullator.

Më 20 mars 2016, shoqëria mëmë përfundimtare e Degës, shpalli hyrjen në një marrëveshje përfundimtare (“Marrëveshja”) për blerjen e të gjitha aksioneve të zakonshme të emetuara dhe në qarkullim me një çmim në para prej 2.2 dollarë kanadez (“CAD”) për aksion nga një palë e lidhur e Geo-Jade Petroleum Corporation, një shoqëri e pavarur në Kinë e angazhuar në eksplorimin dhe prodhimin e naftës dhe gazit. Marrëveshja e vlerëson Bankers afërsisht 575 milionë CAD pa konsideruar nivelin e borxhit të Bankers. Realizimi i Marrëveshjes është subjekt i kushteve normale përmbyllëse, që përfshijnë marrjen aprovimeve gjyqësore, rregullatore dhe nga aksionarët.

## **2. BAZAT E PËRGATITJES**

Pasqyrat financiare të Degës janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”) të lëshuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (“BNSK”).

## **3. MONEDHA FUNKSIONALE DHE RAPORTUESE**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në Lek Shqiptar (“Lekë”), që ndryshon nga monedha funksionale e Degës, Dollari Amerikan (“USD”). Të gjitha shumat janë rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, nëse nuk është shprehur ndryshe.

## **4. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE**

Përgatitja e pasqyrave financiare të konsoliduar në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të kryejë vlerësime dhe të përdorë gjykimin në lidhje me shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, dhe shënimet për aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara në datën e pasqyrave të konsoliduara dhe me shumat e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë vitit. Për shkak të natyrës së tyre, vlerësimet janë subjekt i pasigurive në matje dhe ndryshimet në këto vlerësime në periudhat e ardhme mund të kërkojnë një ndryshim material në pasqyrat financiare. Prandaj, rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga shumat e vlerësuara kur ndodhja e ngjarjeve të ardhshme vërtetohet. Vlerësimet dhe gjykimet e rëndësishme të kryera nga drejtimi për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë si më poshtë:

### *(a) Rikuperimi i vlerës kontabël të aktiveve*

Rikuperimi i vlerës kontabël të aktiveve të naftës vlerësohet në nivelin e njësisë gjeneruese të parasë (NJGJP). Përcaktimi se nga çfarë përbëhet një NJGJP është subjekt i gjyqimeve të drejtimit. Përbërja e aktiveve të NJGJP-së mund të ndikojë drejtpërsëdrejti rikuperimin e aktiveve të përfshira në të. Vlerësimet kyçe të përdorura në përcaktimin e flukseve monetare nga rezervat e naftës përfshijnë sa më poshtë:

#### **4. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)**

*(a) Rikuperimi i vlerës kontabël të aktiveve (vazhdim)*

(i) Rezervat – Supozimet që janë të vlefshme në kohën e vlerësimit të rezervave mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme kur vihet në dispozicion informacion i ri. Ndryshimet në vlerësimin e çmimeve të ardhshme, kostove të prodhimit ose shkallës së rikuperimit mund të ndryshojnë statusin ekonomik të rezervave dhe në fund mund të çojnë në riparaqitjen e tyre.

(ii) Çmimet e naftës – Vlerësimet e çmimeve të ardhshme përdoren në modelin e fluksit të parasë. Çmimet e produkteve mund të luhaten për shumë arsye që përfshijnë ofertën dhe kërkesën e produkteve kryesore, nivelet e inventarit, kurset e këmbimit, motin si dhe faktorët ekonomikë dhe gjeopolitikë.

(iii) Norma e skontimit – Norma e skontimit që përdoret për llogaritjen e vlerës aktuale neto të flukseve monetare bazohet në vlerësimin e një kostoje të ponderuar kapitali të shoqërive të ngjashme të industrisë. Ndryshimet në mjedisin e përgjithshëm ekonomik mund të rezultojnë në ndryshime të rëndësishme të këtij vlerësimi.

*(b) Harxhimi dhe amortizimi*

Shumat e regjistruara për harxhimin dhe amortizimin dhe shumat e përdorura në llogaritjen e zhvlerësimit janë bazuar në vlerësime të rezervave totale të vërtetuara dhe të mundshme të naftës dhe gazit natyror dhe të kapitalit të ardhshëm të zhvillimit. Për shkak të natyrës së tyre, vlerësimet e rezervave, përfshirë vlerësimet e çmimeve, kostove dhe flukseve monetare të ardhshme, janë subjekt i pasigurisë në matje. Prandaj, ndikimi në pasqyrat financiare në periudhat e ardhshme mund të jetë i rëndësishëm.

*(c) Detyrim për nxjerrje nga përdorimi*

Shumat e regjistruara për detyrimin për nxjerrje nga përdorimi dhe shpenzimin përkatës për rritjen e këtij detyrimi kërkojnë një vlerësim të shumës dhe kohës së kryerje së shpenzimeve për nxjerrje nga përdorimi. Kostot dhe flukset monetare dalëse aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimet për shkak të ndryshimeve në ligje dhe rregullore, pritshmëritë e publikut, kushtet e tregut, zbulimit dhe analizës së kushteve të terrenit dhe ndryshimeve në teknologji. Provizionet e tjera njihen në periudhën kur bëhet e mundshme që do të ketë flukse monetare dalëse të ardhshme.

*(d) Pagesa bazuar në aksione*

Kostot e kompensimit të njohura për planet e pagesave bazuar në aksione janë subjekt i vlerësimit se cila do të jetë pagesa përfundimtare duke përdorur modele të vlerësimit të çmimit si modeli Black-Scholes i çmimit të opsionit i cili bazohet në supozime të rëndësishme si luhatshmëria, kthimi i dividendit, norma e dështimit dhe afati i pritshëm i opsioneve.

Kostot e kompensimit të njohura për shpërblimet në formën e aksioneve të kufizuara përcaktohen në datën e dhënies duke përdorur çmimin e mbylljes të aksioneve të zakonshme dhe një normë të vlerësuar dështimi.

*(e) Tatimi i shtyrë*

Interpretimet tatimore, rregulloret dhe legjislacioni në juridiksionin ku vepron Dega janë subjekt ndryshimi. Në këtë mënyrë, tatimi mbi fitimin është subjekt i pasigurive në matje. Aktivitet tatimore të shtyra vlerësohen nga drejtimi në fund të periudhës raportuese për të përcaktuar mundësinë e realizimit të tyre nga fitimet tatimore të ardhshme.

*(f) Përcaktimi i monedhës funksionale*

Në përcaktimin e monedhës funksionale, kërkohet një gjykim i rëndësishëm për të konsideruar se cila është monedha e mjedisit ekonomik parësor ku vepron Dega. Në këtë gjykim, prioritet i jepet marrjes në konsideratë të treguesve parësorë dhe më pas atyre dytësorë të monedhës funksionale të një shoqërie dhe një gjykim i rëndësishëm përdoret në përcaktimin e monedhës funksionale që përfaqëson në mënyrë më të sinqertë transaksionet, ngjarjet dhe kushtet kryesore të Degës.

#### **4. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)**

*(g) Rreziku ligjor*

Drejtimi i Degës ka krijuar një proces të brendshëm për njohjen dhe matjen e provizioneve dhe angazhimeve të lidhura me çështje ligjore aktuale ose të mundshme. Supozimet kryesore mbi mundësinë dhe madhësinë e një fluksi dalës burimesh bazohen në këshillat ligjore të brendshme dhe të jashtme duke ndjekur strategjitë përkatëse për një mbrojtje të suksesshme. Çdo veprim dhe rrezik përgjegjës vlerësohet sipas meritës së tij dhe detyrimit ligjor ose konstruktiv që i takon si dhe vlerësimi i flukseve dalëse monetare që konsiderohen të pagueshme, miratohen në mënyrë të pavarur nga drejtori i financës së shoqërisë mëmë përfundimtare (shiko shënimin 27).

#### **5. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL**

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme nga Dega në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

**(a) Baza e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

**(b) Monedha e huaj**

*Transaksionet në monedhë të huaj*

Transaksionet e shprehura në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale të Degës me kurset e këmbimit të datave të transaksioneve.

Aktivitet dhe detyrimet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivitet dhe detyrimet jo monetare që maten me vlerë të drejtë në një monedhë të huaj, përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit historik kur përcaktohet vlera e drejtë. Zërat jo monetarë që maten bazuar në koston historike të shprehura në monedhë të huaj përkthehen me kurset e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat e këmbimit njihen në fitim ose humbje.

*Përkthimi në monedhën raportuese*

Aktivitet dhe detyrimet e Degës, përkthehen në Lek me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Të ardhurat, shpenzimet dhe flukset monetare të Degës përkthehen në Lek me një kurs të përshtatshëm mesatar këmbimi për periudhën. Diferencat nga përkthimi njihen në të ardhurat e tjera përmbledhëse dhe akumulohen në rezervën nga përkthimi në monedhë të huaj.

**(c) Instrumentet financiarë**

Dega mban vetëm instrumente financiarë jo derivativë të përbërë nga llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, mjete monetare të ngurtësuar, mjete monetare dhe ekuivalentë dhe llogari të pagueshme e detyrime të përllogaritura. Njohja fillestare e instrumenteve financiarë jo derivativë bëhet me vlerën e drejtë plus, për instrumentet jo me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, kostot neto të transaksionit të lidhura drejtpërdrejtë me to. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiarë jo derivativë maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Një instrument financiar njihet fillimisht në datën e tregimit kur Dega bëhet palë në termat e kontraktuara të instrumentit. Aktivitet financiare çregjistrohen kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetareve nga aktivi maturohen ose kur Dega i transferon aktivitet financiarë te një palë tjetër pa mbajtur kontroll thelbësor mbi rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen kur detyrimet kontraktuale të Degës anulohen ose maturohen. Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe paraqiten për shumën neto në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë dhe vetëm atëherë kur Dega aktualisht ka një të drejtë ligjore të detyrueshme për të kompensuar shumat dhe synon t'i kompensojë ato mbi baza neto ose të përfitojë aktivin dhe shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

## **5. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

### **(c) Instrumentet financiarë (vazhdim)**

#### *(i) Mjete monetare dhe ekuivalentë*

Mjetet monetare dhe ekuivalentë përfshijnë paratë në arkë, depozitat pa afat, investime të tjera afatshkurtra shumë likuide me maturitet fillestar tre muaj ose më pak, që janë subjekt i një rreziku jo të rëndësishëm të ndryshimit në vlerën e drejtë dhe që përdoren nga Dega në menaxhimin e detyrimeve afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentët njihen me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

#### *(ii) Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera*

Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe maten më pas me koston e tyre të amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi.

#### *(iii) Të pagueshme dhe detyrime të llogaritura*

Të pagueshmet dhe detyrimet e llogaritura njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më tej me kosto të amortizuar.

### **(d) Aktive kërkimi dhe vlerësimi**

Shpenzimet para licencimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato ndodhin.

Kostot e kërkimit dhe vlerësimit (K&V), duke përfshirë koston e blerjes së licencës dhe kostot administrative dhe të përgjithshme që mund të atribuohen drejtpërdrejt, njihen fillimisht si aktive materiale ose jo materiale të kërkimit dhe vlerësimit në bazë të natyrës së aktivitetit të blerës. Këto kosto akumulohen në qendra kostosh sipas puseve, fushave ose zonave të kërkimit në pritje të përcaktimit të përshtatshmërisë teknike dhe tregtare.

K&V testohen për zhvlerësim nëse: (i) ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme për të përcaktuar përshtatshmërinë teknike dhe tregtare, dhe (ii) faktet dhe rrethanat sugjerojnë që vlera kontabël e tejkalon vlerën e rikuperueshme. Për qëllime të testit të zhvlerësimit aktivitetet e K&V vlerësohen sipas zonës së kërkimit.

Përshtatshmëria teknike dhe tregtare e nxjerrjes së burimeve minerare konsiderohet se mund të përcaktohet kur ekzistojnë rezerva të vërtetuara dhe/ose të mundshme. Një rishikim i çdo licence kërkimi duhet të kryhet, të paktën çdo vit, për t'u siguruar nëse janë zbuluar rezerva të vërtetuara dhe/ose të mundshme. Pas përcaktimit të rezervave të vërtetuara dhe/ose të mundshme, aktivitetet e K&V që i atribuohen këtyre rezervave fillimisht testohen për zhvlerësim dhe më pas riklasifikohen nga aktive të K&V në një kategori të veçantë brenda aktiveve afatgjata materiale e njohur si aktive nafte.

### **(e) Aktivitet afatgjata materiale**

#### *(i) Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale, që përfshijnë dhe aktivitetet e naftës, janë matur me kosto minus harxhimin dhe amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar të zhvlerësimit t. Aktivitetet e naftës grupohen në NJGJP për qëllime testimi për zhvlerësim. Dega i ka grupuar aktivitetet e naftës në një NJGJP e cila është fusha naftëmbajtëse e Patos-Marinzës.

Nëse pjesë të rëndësishme të një grupi të aktivesh afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato do të trajtohen si elementë më vete (komponentë kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

Çdo fitim ose humbje nga shitja apo nxjerrja nga përdorimi e një aktiviteti afatgjatë material njihet në të ardhura ose shpenzime.

## **5. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

### **(e) Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)**

#### *(ii) Kostot e mëpasshme*

Kostot që ndodhin pas përcaktimit të përshtatshmërisë fizike dhe tregtare dhe kostot e zëvendësimit të pjesëve të aktiveve afatgjata materiale njihen si aktive nafte vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të aktivitetit specifik me të cilin lidhen. Të gjithë shpenzimet e tjera njihen në fitim ose humbje kur ndodhin. Kapitalizimi i aktiveve të naftës përgjithësisht përfaqëson kosto që lidhen me zhvillimin e rezervave të vërtetuara dhe/ose të mundshme dhe me mundësimin apo rritjen e prodhimit nga këto rezerva, dhe akumulohen sipas fushës ose zonës gjeo-teknike. Vlera kontabël e çdo aktiviteti të zëvendësuar ose të shitur çregjistrohet. Kostot e mirëmbajtjes së përditshme të aktiveve afatgjata njihen në fitim ose humbje kur ndodhin.

#### *(iii) Harxhimi dhe amortizimi*

Vlera kontabël e aktiveve të naftës harxhohet duke përdorur metodën e njëjësive të prodhimit mbi bazën e raportit të prodhimit gjatë vitit ndaj rezervave përkatëse të vërtetuara dhe të mundshme, duke marrë në konsideratë kostot e ardhshme të vlerësuara të zhvillimit të nevojshme për të kthyer këto rezerva në prodhim. Këto vlerësime rishikohen nga inxhinierë të pavarur rezervash së paku çdo vit.

Rezervat e vërtetuara dhe të mundshme vlerësohen duke përdorur raportet e inxhinierëve të pavarur të rezervave dhe përfaqësojnë sasinë e vlerësuara të naftës së bruto, gazit natyror dhe gazit natyror të lëngshëm, për të cilat të dhënat gjeologjike, gjeofizike dhe inxhinierike tregojnë me një shkallë të caktuar sigurie që janë të rikuperueshme në vitet e ardhshme nga rezervuarë të njohur dhe të cilat konsiderohen të jenë të prodhueshme për tregtim. Për aktive të tjera, amortizimi njihet në fitim ose humbje me metodën lineare ose me atë zbritëse përgjatë jetëgjatësisë së dobishme të vlerësuar të çdo pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale. Toka nuk amortizohet.

Kostot e ndërhyrjes në puse amortizohen me metodë lineare për 5 vite. Pajisjet, mbyllet dhe instalimet amortizohen me metodën zbritëse me norma nga 20% deri në 30%.

### **(f) Inventarët**

Inventarët përbëhen nga naftë bruto, hollues, karburant dhe inventar tjetër që vlerësohet me vlerën më të ulët mes kostos mesatare të prodhimit dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme vlerësohet me çmimin e shitjes në veprimtarinë normale të biznesit minus kostot e përfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

### **(g) Zhvlerësimi**

#### *(i) Aktivet financiare*

Një aktiv financiar vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive për zhvlerësim. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse evidenca objektive tregon që një ose më shumë ngjarje kanë patur efekt negativ mbi flukset e ardhshme monetare të gjeneruara nga ky aktiv.

Dega konsideron evidencat e zhvlerësimit për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuara në nivel individual dhe kolektiv. Të gjithë aktivet individualisht të mëdha vlerësohen individualisht për zhvlerësim. Ato që nuk rezultojnë të zhvlerësuara vlerësohen më pas në mënyrë kolektive për ndonjë zhvlerësim të ndodhur, por ende jo të identifikuar në mënyrë individuale. Aktivet jo individualisht të mëdha vlerësohen për zhvlerësim në mënyrë kolektive. Vlerësimi kolektiv bëhet duke grupuar së bashku aktive me karakteristika rreziku të ngjashme.

Një humbje nga zhvlerësimi llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare, skontuar me interesin efektiv fillestar. Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe reflektohen në një llogari zbritjeje nga zhvlerësimi. Kur Dega konsideron që nuk ka një perspektivë reale të rikuperimit të aktivitetit, shumat përkatëse fshihen. Nëse më vonë shumat e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet dhe zvogëlimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pas njohjes së zhvlerësimit, humbja nga zhvlerësimi e njohur më parë rimerret në fitim ose humbje.

## **5. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

### **(g) Zhvlerësimi (vazhdim)**

#### *(ii) Aktivet jo financiare*

Vlerat kontabël të aktiveve jo financiare të Degës, përveç aktiveve të K&V dhe tatimit të shtyrë, rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Nëse një tregues i tillë ekziston, vlerësohet shuma e rikuperueshme e aktivit. Aktivet K&V vlerësohen për zhvlerësim kur riklasifikohen në aktive afatgjata materiale dhe gjithashtu nëse faktet dhe rrethanat sugjerojnë që vlera kontabël e tejkalon vlerën e rikuperueshme.

Për qëllime testimi për zhvlerësim, aktivet grupohen së bashku në grupin më të vogël të aktiveve që gjeneron flukse monetare hyrëse nga përdorimi i vazhdueshëm, gjerësisht të pavarura nga flukset monetare hyrëse të aktiveve ose NJGJP-ve të tjera. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose një NJGJP-je është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë, minus kostot e shitjes.

Vlera e drejtë, minus kostot e shitjes, përcaktohet si vlera që mund të përfitohet nga shitja e një NJGJP-je në një transaksion të rregullt midis palësh të mirë informuara dhe me vullnetin e duhur. Vlera e drejtë, minus kostot e shitjes e aktiveve të naftës zakonisht përcaktohet si vlera aktuale neto e flukseve të ardhshme të vlerësuara monetare që pritet të vijnë nga përdorimi i vazhdueshëm i NJGJP-së, përfshirë çdo zgjerim në perspektivë dhe nxjerrjen nga përdorimi, duke përdorur supozimet që do të merreshin në konsideratë nga një pjesëmarrës i pavarur i tregut. Këto flukse monetare skontohehen më një normë të përshtatshme skontimi e cila do të përdorej nga një pjesëmarrës tregu për të arritur në vlerën aktuale neto të NJGJP-së.

Vlera në përdorim përcaktohet si vlera aktuale neto e flukseve të ardhshme të vlerësuara monetare që pritet të vijnë nga përdorimi i vazhdueshëm i aktivit në formën aktuale dhe nga nxjerrja nga përdorimi. Vlera në përdorim përcaktohet duke përdorur supozime specifike të përdorimit të vazhdimësi të Degës dhe mund të marrë në konsideratë vetëm kostot e ardhshme të aprovuara të zhvillimit. Vlerësimet e flukseve të ardhshme monetare të përdorura në përcaktimin e zhvlerësimit të aktiveve bëhen duke përdorur parashikimet e drejtimit për çmimet e naftës dhe volumin e pritshëm të prodhimit.

Kjo e fundit merr parasysh vlerësimet e performancës së rezervuarit të fushës që përfshin pritshmëritë rreth volumeve të vërtetuara dhe të pavërtetuara, të cilat janë të ponderuara me rrezikun duke përdorur projekte gjeologjike, ekonomike të prodhimit dhe rikuperimit.

Aktivitet e K&V vlerësohen sipas zonës së eksplorimit kur testohen për zhvlerësim, kur vërtetohen fakte dhe rrethana që shkaktojnë zhvlerësim si dhe kur riklasifikohen në aktive prodhuese.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje nëse vlera kontabël e një aktivi ose NJGJP-je tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura për NJGJP-të shpërndahen për të pakësuar vlerën kontabël të aktiveve të tjera të njësisë (grupit të njësisë) në mënyrë proporcionale.

Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në vitet e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për tregues që humbja është zvogëluar ose nuk ekziston më. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimin e përdorur për të matur vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret vetëm në masën që vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të kishte, neto nga harxhimi ose amortizimi, nëse nuk do të ishte njohur humbje nga zhvlerësimi.

### **(h) Pagesa bazuar në aksione**

Vlera e drejtë e opsioneve në datën e dhënies punonjësve, drejtorëve dhe ofruesve të shërbimeve matet duke përdorur modelin e vlerësimit të çmimit të opsioneve Black-Scholes dhe njihet si shpenzim, me një rritje përkatëse të kontributit shtesë gjatë periudhës së realizimit. Në datën e dhënies vlerësohet një normë dështimi e cila rregullohet për të reflektuar numrin aktual të opsioneve që realizohen. Opsionet janë emetuar sipas planit të aksioneve të shoqërisë mëmë përfundimtare dhe Degës i shpërndahet shpenzimi për opsionet e dhëna zyrtarëve dhe punonjësve të saj.

## **5. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

### **(h) Pagesa bazuar në aksione (vazhdim)**

Vlera e drejtë e aksioneve të kufizuara matet në datën e dhënies duke përdorur çmimin e mbylljes të aksioneve të zakonshme dhe një normë të vlerësuar dështimi. Kostot e kompensimit njihen si shpenzim, përkundëjt rritjes përkatëse në kontributin shtesë gjatë periudhës së realizimit. Në datën e dhënies së aksioneve të kufizuara, vlerësohet një normë dështimi e cila rregullohet për të reflektuar numrin aktual të njësisve të aksioneve që realizohen. Aksionet e kufizuara emetohen sipas planit të aksioneve të kufizuara të shoqërisë mëmë përfundimtare dhe Degës i shpërndahet shpenzimi për aksionet e kufizuara dhënë zyrtarëve dhe punonjësve të saj.

### **(i) Detyrimi për nxjerrje nga përdorimi**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Dega ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv që mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundshme që për shlyerjen e detyrimit të ketë dalje të përfitimeve ekonomike. Provizionet maten duke skontuar flukset e pritshme në të ardhmen me një normë pa rrezik dhe përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun specifik të detyrimit. Provizionet nuk njihen për humbje operative të së ardhmes.

Aktiviteti i Degës sjell nevojën e kryerjes së aktiviteteve të çmontimit, nxjerrjes nga përdorimi dhe rehabilitimit të mjedisit kur tërheq nga përdorimi aktivet afatgjata materiale të tilla si pajisjet e puseve prodhuese. Provizioni llogaritet për koston e vlerësuar të restaurimit të terrenit dhe kapitalizohet në kategorinë e duhur të aktivitetit.

Detyrimi për nxjerrje nga përdorimi matet me vlerën aktuale të vlerësimit më të mirë nga ana e drejtimit të shpenzimeve që kërkohen për mbylljen e detyrimit aktual në datën e raportimit. Pas matjes fillestare, detyrimi rregullohet në fund të çdo periudhe për të reflektuar kalimin e kohës dhe ndryshimet në flukset e ardhshme të vlerësuara monetare që përbëjnë detyrimin. Rritja e provizionit nga kalimi i kohës njihet si shpenzim financiar ndërsa rritjet/uljet për shkak të ndryshimeve në flukset e ardhshme të vlerësuara monetare kapitalizohen. Këto kosto të kapitalizuara amortizohen nëpërmjet harxhimit dhe zhvlerësimit duke përdorur metodën e njësisve të prodhimit. Kostot faktike për të përmbushur detyrimin për nxjerrje nga përdorimi i ngarkohen provizionit deri në shumën e krijuar të provizionit.

### **(j) Të ardhurat**

Të ardhurat nga shitja e naftës së Degës regjistrohen kur rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi produktin i transferohen blerësit, që ndodh zakonisht kur të drejtat ligjore i kalojnë palës tjetër. Kjo ndodh përgjithësisht në kohën kur produkti transportohet (shitjet me eksport) ose dorëzohet në rafineri (shitjet brenda vendit).

### **(k) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare përfshijnë:

- të ardhura interesi;
- shpenzime interesi dhe komisione bankare;
- rritjen e detyrimit për nxjerrje nga përdorimi;
- humbjen ose fitimin nga kurset e këmbimit për detyrimet dhe aktivet financiare, raportuar neto.

Të ardhurat ose shpenzimet e interesit njihen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen në bazë neto.

## **5. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

### **(l) Tatimi mbi fitimin**

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe të shtyrë. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet në fitim ose humbje, përveçse kur lidhet me zëra që njihen drejtpërdrejt në kapital ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

#### *Tatim aktual*

Tatim aktual është tatimi i pritshëm për t'u paguar për vitin mbi fitimin e tatueshëm dhe çdo rregullim i tatimit për t'u pagur ose arkëtuar në lidhje me vitet e mëparshme. Vlera e tatimit të fitimit për t'u paguar ose arkëtuar është vlerësimi më i mirë i vlerës së tatimit që pritet të paguhet ose arkëtohet dhe që reflekton pasigurinë në lidhje me tatimin mbi fitimin, nëse ka. Tatimi aktual matet duke përdorur normat tatimore në fuqi ose që pritet të hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

#### *Tatimi i shtyrë*

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferenca të përkohshme ndërmjet vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Aktivitet tatimore të shtyra njihen për humbjet tatimore të papërdorura, teprica kreditore tatimore dhe diferenca të përkohshme të zbritshme në masën që është e mundshme që përfitime të ardhshme tatimore do të sigurohen ndaj të cilave këto aktive do të përdoren. Aktivitet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportuese dhe pakësohen në momentin që nuk është më e pritshme që përfitimet e ardhshme tatimore do të realizohen; këto pakësime rimerren kur probabiliteti për përfitime të ardhshme tatimore përmirësohet. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të zbatohen ndaj diferencave të përkohshme në momentin që këto do të rimerren, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose që pritet të hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

### **(m) Standarde të reja të cilat nuk janë adoptuar ende**

Disa standarde të reja, ndryshime të standardeve ekzistuese dhe interpretime nuk ishin ende në fuqi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015, dhe Dega nuk i ka zbatuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Ato standarde që mund të ndikojnë te Dega përcaktohen më poshtë:

#### ***SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët***

*SNRF 15, Të ardhurat nga kontratat me klientët* (hyn në fuqi për periudhat duke filluar nga ose pas 1 janar 2018, zbatimi më i hershëm është i lejueshëm). Ky standard zëvendëson standardin ekzistues udhëzues për njohjen e të ardhurave, përfshirë *SNK 18 Të ardhurat*, *SNK 11 Kontratat për Ndërtimin dhe IFRIC 13 Programet për Besnikërinë e Klientit*. Standardi i ri prezanton parimin bazë se të ardhurat duhet të njihen kur mallrat ose shërbimet transferohen tek konsumatori, me çmimin e transaksionit. Mallrat ose shërbimet e tregtuara në grup që janë të dallueshëm duhet të njihen veçmas, dhe uljet apo zbritjet në çmimin e kontratës duhet të përgjithësi t'i alokohen elementeve të veçanta. Kur pagesa ndryshon për çfarëdolloj arsye, duhet të njihen shumat minimale nëse ka rrezik të konsiderueshëm për anulimin e tyre. Shpenzimet për të siguruar kontrata me klientët duhet të kapitalizohen dhe amortizohen gjatë periudhës kur përfitimet e kontratës konsumohen. Dega, në koordinim me Grupin, është duke vlerësuar ndikimin e mundshëm në pasqyrat financiare nga zbatimi i SNRF 15.

#### ***SNRF 9 Instrumentet financiarë***

SNRF 9, publikuar në korrik 2014, zëvendëson udhëzimin ekzistues të *SNK 39 Instrumentet Financiare*: Njohja dhe Vlerësimi. SNRF 9 përfshin udhëzimin e rishikuar për klasifikimin dhe vlerësimin e instrumenteve financiare, përfshirë një model të ri të humbjes së pritshme të kredisë për llogaritjen e zhvlerësimit të aktiveve financiare, dhe kërkesat e reja të përgjithshme të kontabilitetit mbrojtës. Ky standard jep udhëzime të mëtejshme në lidhje me njohjen dhe mos-njohjen e instrumenteve financiare nga SNK 39. SNRF 9 hyn në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2018 dhe zbatimi i mëhershëm është i lejuar. Dega, në koordinim me grupin, është duke vlerësuar ndikimin e mundshëm në pasqyrat financiare nga zbatimi i SNRF 9.



## **5. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)**

### **(m) Standarde të reja të cilat nuk janë adoptuar ende (vazhdim)**

#### ***SNRF16 Qiratë***

SNRF 16 hyn në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019, dhe zbatimi i mëhershëm lejohet, por vetëm në qoftë se njësia ekonomike zbaton edhe *SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët*. SNRF 16 zëvendëson standardin e mëparshëm të qirave, *SNK 17 Qiratë* dhe interpretimet që lidhen me të. Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen dhe paraqitjen e qirave për të dyja palët në një kontratë, pra klientit ('qiramarrësi') dhe furnizuesit ('qiradhënësi'). SNRF 16 eliminon klasifikimin e qirave ose si qira operative ose qira financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, paraqet një model të vetëm të kontabilitetit për qiramarrësin. Duke zbatuar këtë model, një qiramarrës është i detyruar të njohë: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me afat për më shumë se 12 muaj, përveç rasteve kur aktivi është me vlerë të ulët; dhe (b) amortizimin e aktiveve me qira veçmas nga interesi për detyrimet e qirasë në pasqyrën e të ardhurave. SNRF 16 në thelb është vazhdim i kërkesave të kontabilitetit për qiradhënësin si në SNK 17. Përkatësisht, një qiradhënësi vazhdon të klasifikojë qiratë si qira operative ose qira financiare, dhe të japë llogari për këto dy lloje të qirave ndryshe. Dega, në koordinim me grupin, është duke vlerësuar ndikimin e mundshëm në pasqyrat e saj financiare nga zbatimi i SNRF 16.

Standarde të tjera të ndryshuara nuk priten të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Degës.

## **6. PËRCAKTIMI I VLERËS SË DREJTË**

Politikat kontabël dhe shënimet e Degës kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar sipas metodave të mëposhtme. Për supozimet e bëra në lidhje me përcaktimin e vlerës së drejtë jepet më shumë informacion në shënimet përkatëse të aktivit apo detyrimit, atëherë kur është e zbatueshme.

Gjatë matjes së vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve, Dega përdor sa më shumë të jetë e mundur të dhënat e tregut. Vlera e drejtë kategorizohet në nivele të ndryshme të hierarkisë së vlerës së drejtë bazuar në të dhënat e përdorura në teknikat e vlerësimit si më poshtë:

Niveli 1: çmimi i kuotuar (i parregulluar) në tregje aktive për aktive dhe detyrime të njëjta

Niveli 2: të dhëna të tjera përveç çmimit të kuotuar në Nivelin 1, që janë të vrojtueshme për aktive dhe detyrime, qoftë drejtpërdrejtë (p.sh. çmimet) ashtu edhe jo drejtpërdrejtë (p.sh. derivat nga çmimet)

Niveli 3: të dhëna për aktive dhe detyrime që nuk bazohen në të dhëna të vrojtueshme tregu. Nëse të dhënat që përdoren për të matur vlerën e drejtë të një aktivi ose detyrimi u përkasin niveleve të ndryshme të hierarkisë së vlerës së drejtë, atëherë matja e vlerës së drejtë kategorizohet në tërësinë e saj në të njëjtin nivel hierarkie të vlerës së drejtë si niveli më i ulët i të dhënave që janë të rëndësishme për matjen në tërësi. Dega i njeh transferimet ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në fund të periudhës së raportimit gjatë së cilës ka ndodhur ndryshimi.

*(a) Aktivet afatgjata materiale (AAM) dhe aktivet e kërkimit dhe vlerësimit (K&V).*

Vlera e drejtë e shumës së njohur të AAM dhe aktiveve të K&V, si dhe e detyrimit për nxjerrje nga përdorimi të njohur në lidhje me to, bazohet në vlerat e tregut. Vlera e tregut e AAM dhe aktiveve të K&V është shuma e vlerësuar për të cilën aktivet mund të këmbehen në datën e blerjes ndërmjet një blerësi dhe një shitësi të vullnetshëm, në një transaksion të lirë dhe pas një marketingu të duhur ku palët kanë vepruar secila në mënyrë të mirë informuar të kujdesshme dhe pa qenë të detyruara. Vlera e tregut e aktiveve të naftës (përfshirë në AAM) dhe aktiveve të K&V vlerësohet në bazë të flukseve të skontuara monetare që priten të përfitohen nga prodhimi i naftës dhe gazit natyror bazuar në raportet e rezervës të përgatitura së jashtmi. Norma e skontimit e rregulluar me rrezikun është specifike për aktivet duke iu referuar kushteve të përgjithshme të tregut.

**Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri**  
**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

**6. PËRCAKTIMI I VLERËS SË DREJTË**

(b) Mjete monetare dhe ekuivalentë, mjete monetare të ngurtësuara, të arkëtueshme tregtare dhe të tjera, të pagueshme dhe detyrime të përlllogaritura

Vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve, mjeteve monetare të ngurtësuara, të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera, të pagueshmeve dhe detyrimeve të përlllogaritura vlerësohet si vlera aktuale e flukseve të ardhshme monetare të skontuara me normën e interesit të tregut në datën e raportimit. Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve, mjeteve monetare të ngurtësuara, të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera, të pagueshmeve dhe detyrimeve të përlllogaritura i përafrohet vlerës kontabël për shkak të maturitetit afatshkurtër.

Shënime	Vlera kontabël				
	Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	Aktive financiare të tjera	Të pagueshme tregtare dhe të tjera	Detyrime financiare të tjera	Totali i vlerës kontabël
<b>31 dhjetor 2015</b>					
Mjete monetare dhe ekuivalentë	16	34,467	-	-	34,467
Mjete monetare të ngurtësuara	17	1,719,169	-	-	1,719,169
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	19,20	5,630,806	3,458,428	-	9,089,234
<b>Totali</b>		<b>7,384,442</b>	<b>3,458,428</b>	-	<b>10,842,870</b>
Hua	24	-	-	2,120,219	2,120,219
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	20	-	-	37,910,829	37,910,829
Të pagueshme dhe detyrime të përlllogaritura	25	-	4,345,814	-	4,345,814
<b>Totali</b>		-	-	<b>4,345,814</b>	<b>44,376,862</b>
<b>31 dhjetor 2014</b>					
Mjete monetare dhe ekuivalentë	16	561,595	-	-	561,595
Mjete monetare të ngurtësuara	17	576,150	-	-	576,150
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	19,20	5,552,603	3,458,428	-	9,011,031
<b>Totali</b>		<b>6,690,348</b>	<b>3,458,428</b>	-	<b>10,148,776</b>
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	20,25	-	-	30,101,828	30,101,828
Të pagueshme dhe detyrime të përlllogaritura	24	-	7,120,134	-	7,120,134
<b>Totali</b>		-	-	<b>7,120,134</b>	<b>37,221,962</b>

## **6. PËRCAKTIMI I VLERËS SË DREJTË (VAZHDIM)**

### *(c) Opsionet për aksione*

Vlera e drejtë e opsioneve për aksione matet duket përdorur modelin e vlerësimit të çmimit të opsionit Black-Scholes. Të dhënat e matjes përfshijnë çmimin e aksionit në datën e matjes, çmimin e ushtrimit të instrumentit, luhatjet e pritshme (bazuar në luhatshmërinë historike mesatare të ponderuar të rregulluar me ndryshimet që priten nga publikimi i informacionit), mesataren e ponderuar të jetëgjatësisë së pritur të instrumentit (bazuar në eksperiencën historike dhe sjelljet e përgjithshme të mbajtësit të opsionit), dividendët e pritshëm, normën e pritur të dështimit dhe normën e interesit pa rrezik (bazuar në obligacionet qeveritare).

### *(d) Njësitë e aksioneve të kufizuara*

Vlera e drejtë e aksioneve të kufizuara përcaktohet në datën e dhënies duke përdorur çmimin e mbylljes së aksionit të zakonshëm dhe normën e pritshme të dështimit.

## **7. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR**

Aktivitetet e Degës ekspozohen ndaj shumë rreziqeve financiare që mund të vijnë si pasojë e kërkimit, zhvillimit, prodhimit dhe aktiviteteve financiare të tilla si:

- (a) Rreziku i kredisë;
- (b) Rreziku i likuiditetit; dhe
- (c) Rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Degës ndaj secilit rrezik më sipër, objektivate, politikave dhe proceseve të saj për matjen dhe menaxhimin e rrezikut si dhe menaxhimin e kapitalit të saj. Përgjatë këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më shumë shënime sasiore.

Bordi i Drejtorëve mbikëqyr vendosjen dhe zbatimin nga drejtimi të strukturës së menaxhimit të rrezikut të Degës. Drejtimi ka zbatuar dhe monitoruar përputhshmërinë me politikat e menaxhimit të rrezikut. Politikat e menaxhimit të rrezikut të Degës janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat ajo përballlet, për të vendosur kufizimet dhe kontrollin e duhur të rrezikut, dhe për të monitoruar rrezikun dhe përputhshmërinë me kushtet e tregut të aktiviteteve të saj.

### **(a) Rreziku i kredisë**

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjeve financiare të Degës nëse një klient ose **palë tjetër** e një instrumenti financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, dhe lidhet kryesisht me të arkëtueshmet e Degës nga rafineritë e naftës ose autoritetet tatimore.

Vlera kontabël e llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera të arkëtueshme përfaqëson ekspozimin maksimal të kredisë. Më 31 dhjetor 2015, Dega regjistroi një shpenzim zhvlerësimi prej 2,154 milionë Lekë për shumën e arkëtueshme nga një klient brenda vendit prej viteve 2011, 2013 dhe 2015. Më 31 dhjetor 2014, Dega nuk kishte zbritje për zhvlerësime dhe nuk parashikonte ndonjë llogari të dyshimtë dhe as nevojën për të fshirë ndonjë nga të arkëtueshmet.

**Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri**  
**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

*(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)*

**7. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)**

Totali i të arkëtueshmeve tregtare dhe të arkëtueshmeve të tjera është si më poshtë:

<b>2015</b>	<b>Aktuale</b>	<b>30-60 ditë</b>	<b>61-90 ditë</b>	<b>Mbi 90 ditë</b>	<b>Totali</b>
Rafineritë e naftës	1,253,766	-	20,324	11,593	1,285,684
Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH)	4,817,173	-	-	-	4,817,173
<b>Totali</b>	<b>6,070,939</b>	<b>-</b>	<b>20,324</b>	<b>96,962</b>	<b>6,188,226</b>

<b>2014</b>	<b>Aktuale</b>	<b>30-60 ditë</b>	<b>61-90 ditë</b>	<b>Mbi 90 ditë</b>	<b>Totali</b>
Rafineritë e naftës	3,791,483	7	9,694	1,751,419	5,552,603
TVSH	3,458,428	-	-	-	3,458,428
<b>Totali</b>	<b>7,249,911</b>	<b>7</b>	<b>9,694</b>	<b>1,829,622</b>	<b>9,089,234</b>

Dega konsideron në vonesë çdo vlerë të arkëtueshme nga rafineritë e naftës me ditë vonesa më të mëdha se 60 ditë. Llogaritë e arkëtueshme përfshirë në tabelën më lart, me ose pa vonesë, nuk janë zhvlerësuar. Ato janë nga kundër parti me të cilat Dega ka një histori arkëtimesh dhe i konsideron këto llogari si të mbledhshme. Të arkëtueshmet brenda vendit kanë afat pagese në fund të muajit që pason prodhimin dhe të arkëtueshmet nga eksportet arkëtohen brenda 30 ditëve nga data e dërgesës. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) i arkëtueshëm rimburohet nga Autoritetet Tatimore pas kontrollit të tyre verifikues. Politika e Degës për të zvogëluar rrezikun e kredisë lidhur me këto ekspozime është përmes krijimit të një marrëdhënie marketingu me një sërë blerësish.

Nga totali i të arkëtueshmeve prej rafinerive të naftës, një total prej 1,254 milionë Lekë (2014: 3,791 milionë Lekë) duhet të shlyhen brenda 30 ditëve, prej të cilave 1,254 milionë Lekë janë arkëtuar pas 31 dhjetorit 2015. Nga balanca e TVSH-së së arkëtueshme, një vlerë prej 1,020 milionë Lekë është rikuperuar pas 31 dhjetorit 2015 më anë të kompensimit ndaj detyrimeve të tjera tatimore të Degës.

Më 31 dhjetor 2014, afërsisht 1,728 milionë Lekë ishin të arkëtueshme nga një klient brenda vendit. Gjatë vitit, kjo shumë u rrit në 2,154 milionë Lekë. Bazuar në historikun faktik të pagesave dhe në situatën aktuale të tregut, Dega e regjistroi të gjithë shumën si shpenzim zhvlerësimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015.

**(b) Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Dega do të ndeshet me vështirësi në përmbushjen e obligimeve të lidhura me detyrimet e saj financiare që shlyhen me anë të transferimit të mjeteve monetare ose aktiveve të tjera financiare. Përjasja e Degës për të menaxhuar likuiditetin është që të sigurohet sa më shumë të jetë e mundur që do të ketë likuiditet të nevojshëm në përmbushjen e detyrimeve kur ato duhet të paguhen, si në situatë normale ashtu dhe në vështirësi, pa pësuar humbje të papranueshme ose rrezikuar dëmtimin e reputacionit të saj.

Dega sigurohet që do të ketë mjete monetare të mjaftueshme për të përmbushur shpenzimet operative të pritshme për një periudhë minimale prej 30 ditësh, përfshirë shërbimin e detyrimeve financiare; kjo përjashton ndikimin e rrethanave ekstreme që nuk mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, si për shembull katastrofat natyrore. Për të arritur këtë objektiv, Dega përgatit buxhete vjetore të shpenzimeve kapitale, të cilat monitorohen vazhdimisht dhe modifikohen kur konsiderohet e nevojshme.

Për më tepër, Dega përdor autorizime për shpenzime në projektet operative dhe jo operative për të menaxhuar më tej shpenzimet kapitale. Për të lehtësuar programin e shpenzimeve kapitale, Dega ka hua nga një bankë brenda vendit, siç prezantohet në shënimin 21 si dhe fonde pa interes të siguruar nga Grupi. Banka gjithashtu tenton të përshtatë ciklin e pagesave me arkëtimet e të ardhurave nga nafta. Dega mban një marrëdhënie pune të afërt me bankën që i siguron hua.

**Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri**  
**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

*(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)*

**7. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**(b) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Afatet kontraktuale të detyrimeve financiare më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë:

31 dhjetor 2015	Flukset kontraktuale monetare			
	Vlera Kontabël	Totali	Deri në 3 muaj	Pa-përcaktuar
Të pagueshme dhe detyrime të përllogaritura	4,345,814	4,345,814	4,345,814	-
Hua	2,120,219	2,120,219	2,120,219	-
Të pagueshme ndaj palëve e lidhura	37,910,829	37,910,829	-	37,910,829
	<b>44,376,862</b>	<b>44,376,862</b>	<b>6,466,033</b>	<b>37,910,829</b>

31 dhjetor 2014	Flukset kontraktuale monetare			
	Vlera Kontabël	Totali	Deri në 3 muaj	Pa-përcaktuar
Të pagueshme dhe detyrime të përllogaritura	7,120,134	7,120,134	7,120,134	-
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	30,101,828	30,101,828	-	30,101,828
	<b>37,221,962</b>	<b>37,221,962</b>	<b>7,120,134</b>	<b>30,101,828</b>

**(c) Rreziku i tregut**

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, si kurset e këmbimit, normat e interesit, çmimet e naftës, të ndikojnë të ardhurat e Degës ose vlerën e instrumenteve të saj financiare. Objektivi i menaxhimit të rrezikut të tregut është të drejtojë dhe kontrollojë ekspozimin e rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin.

*(i) Rreziku i kursit të këmbimit*

Rreziku i kursit të këmbimit është rreziku që vlera e drejtë e flukseve të ardhshme do të luhatet si rezultat i ndryshimeve në kurset e këmbimit. Ekspozimi i Degës ndaj rrezikut të kursit të këmbimit në shumat ekuivalente në Lek në datën e raportimit është si më poshtë:

<i>(Në mijë Lekë)</i>	31 dhjetor 2015				
	USD	Lek	Euro	CAD	Totali
<b>Aktive financiare</b>					
Mjete monetare dhe ekuivalentë	1,290	23,066	1,121	8,990	34,467
Mjete monetare të ngurtësuara	628,950	1,090,219	-	-	1,719,169
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	85,369	-	-	-	85,369
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	1,285,684	4,817,173	-	-	6,102,857
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>2,001,293</b>	<b>5,930,458</b>	<b>1,121</b>	<b>8,990</b>	<b>7,941,862</b>
<b>Detyrime financiare</b>					
Të pagueshme dhe detyrime të përllogaritura	1,030,626	2,838,221	349,515	127,452	4,345,814
Hua	2,120,219	-	-	-	2,120,219
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	37,910,829	-	-	-	37,910,829
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>41,061,674</b>	<b>2,838,221</b>	<b>349,515</b>	<b>127,452</b>	<b>44,376,862</b>
<b>Pozicioni Neto</b>	<b>(39,060,381)</b>	<b>3,092,237</b>	<b>(348,394)</b>	<b>(118,462)</b>	<b>(36,435,000)</b>

**Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri**  
**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

*(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)*

**7. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**(c) Rreziku i tregut (vazhdim)**

*(i) Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)*

<i>(Në mijë Lekë)</i>	<b>31 dhjetor 2014</b>				
	<b>USD</b>	<b>Lek</b>	<b>Euro</b>	<b>CAD</b>	<b>Total</b>
<b>Aktive financiare</b>					
Mjete monetare dhe ekuivalentë	513,691	9,154	37,941	809	561,595
Mjete monetare të ngurtësuara	576,150	-	-	-	576,150
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	78,203	-	-	-	78,203
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	5,552,603	3,458,428	-	-	9,011,031
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>6,720,647</b>	<b>3,467,582</b>	<b>37,941</b>	<b>809</b>	<b>10,226,979</b>
<b>Detyrimet financiare</b>					
Të pagueshme dhe detyrime të përllogaritura	5,646,246	1,168,127	236,278	69,483	7,120,134
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	30,101,828	-	-	-	30,101,828
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>35,748,074</b>	<b>1,168,127</b>	<b>236,278</b>	<b>69,483</b>	<b>37,221,962</b>
<b>Pozicioni Neto</b>	<b>(29,027,427)</b>	<b>2,299,455</b>	<b>(198,337)</b>	<b>(68,674)</b>	<b>(26,994,983)</b>

Kurset e mëposhtme të këmbimit janë aplikuar:

	<b>Kursi mesatar</b>		<b>Kursi në fund viti</b>	
	<b>2015</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2014</b>
Lek/USD	125.96	105.48	125.79	115.23
Euro/USD	0.90	0.75	0.92	0.82
CAD/USD	1.24	1.10	1.39	1.16

*Analiza ndjeshmërisë*

Një forcim (dobësim) i arsyeshëm i Euros dhe Lekut ndaj USD më 31 dhjetor mund të ndikojë matjen e instrumenteve financiarë që janë në monedhë të huaj si dhe kapitalin dhe fitimin ose humbjen me vlerat e paraqitura më poshtë:

	<b>Fitim ose humbje</b>	
	<b>Forcim</b>	<b>Dobësim</b>
<b>31 dhjetor 2015</b>		
Euro (lëvizje 10%)	112	(112)
Lek (lëvizje 10%)	593,046	(593,046)
<b>31 dhjetor 2014</b>		
Euro (lëvizje 10%)	3,794	(3,794)
Lek (lëvizje 10%)	346,758	(346,758)

*(ii) Rreziku i normës së interesit*

Rreziku i normës së interesit është rreziku që flukset monetare të ardhshme të luhaten nga ndryshimet të normës së interesit të tregut. Dega është ekspozuar nga luhata e normës së interesit të huave operative të cilat kanë një normë interesi variabël. Më 31 dhjetor 2015, një ndryshim 100pb i normës së interesit, me gjithë elementet e tjera konstantë, mund të ndikojë rezultatin neto pas tatimit për vitin me 21 milionë Lekë (2014: zero), bazuar në shumën e borxhit të mbetur në datën e raportimit.

*(iii) Rreziku i çmimit të naftës*

Rreziku i çmimit të naftës është rreziku që vlera e drejtë e flukseve të ardhshme do të luhatet si rezultat i ndryshimeve në çmimin e naftës. Çmimet e naftës ndikohen jo vetëm nga marrëdhënia e Lekut Shqiptar me Dollarin Amerikan por gjithashtu ngjarjet ekonomike botërore diktojnë nivelin e kërkesës dhe ofertës.

Të ardhurat kryesore të Degës janë nga shitja e naftës, me një çmim të bazuar në çmimin e naftës Brent, i ndryshuar sipas cilësisë. Më 31 dhjetor 2015, një ndryshim prej 1\$ për fuçi në çmimin e naftës Brent, me të gjithë elementët e tjerë të mbajtur konstantë, do të ndikonte rezultatin neto pas tatimit për vitin me 302 milionë Lekë (2014: 264 milionë Lekë).

**Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri**  
**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

*(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)*

**8. TË ARDHURAT NETO**

	<b>2015</b>	<b>2014</b>
Të ardhurat nga shitja e naftës bruto:		
Brenda vendit	7,080,527	7,750,311
Eksport	28,499,477	49,989,487
Të marra në natyrë	445,174	3,757,932
	<b>36,025,178</b>	<b>61,497,730</b>
Pagesa për drejta minerare	(5,044,101)	(9,051,600)
<b>Të ardhurat neto</b>	<b>30,981,077</b>	<b>52,446,130</b>

**9. SHPENZIME OPERATIVE**

Tabela e mëposhtme detajon totalin e shpenzimeve operative

	<b>2015</b>	<b>2014</b>
Shërbime për pusët	1,717,227	1,789,226
Transporti	1,588,423	1,897,532
Energji	1,269,691	1,790,541
Qiraja e tokës, lejet dhe taksat lokale	1,012,934	808,429
Riparime dhe mirëmbajtje	869,396	703,785
Personeli dhe kosto të lidhura me të (shih shënimin 11)	824,512	803,526
Shërbime sigurie	820,657	648,520
Shpenzime trajtimi	969,731	588,132
Pajisje shpimi	571,264	427,870
Të tjera	935,324	558,460
<b>Totali</b>	<b>10,579,159</b>	<b>10,016,021</b>

**10. SHPENZIMET E SHITJES DHE TRANSPORTIT**

	<b>2015</b>	<b>2014</b>
Kosto e holluesve	3,258,467	4,510,236
Kostot e transportit	1,626,695	1,761,858
	<b>4,885,162</b>	<b>6,272,094</b>

**11. SHPENZIMET TË PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE**

Tabela e mëposhtme detajon shumën totale të shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative:

	<b>2015</b>	<b>2014</b>
Personeli dhe kosto të lidhura me të (shih më poshtë)	544,162	555,879
Shpenzime ligjore, sigurim, taksa lokale	286,730	285,827
Komunikim dhe TI	179,627	118,591
Strehim dhe shërbime utilitare	172,416	189,421
Marrëdhënie me komunitetin dhe publikun	50,583	50,480
Riparim dhe mirëmbajtje	50,415	49,145
Të tjera	110,002	188,362
<b>Totali</b>	<b>1,393,935</b>	<b>1,437,705</b>

Tabela e mëposhtme detajon shumën totale të kompensimit të punonjësve duke përfshirë shpenzimet operative dhe shpenzimet e përgjithshme administrative:

	<b>2015</b>	<b>2014</b>
Pagat	1,004,909	978,165
Kontributet shoqërore	59,075	55,933
Sigurimi i shëndetit dhe jetës	70,412	64,287
Shpërblime	138,926	178,883
Të tjera	95,344	82,137
<b>Totali</b>	<b>1,368,674</b>	<b>1,359,405</b>

**Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri**  
**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

*(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)*

**12. SHPENZIME PËR ZGJIDHJE KONTRATE**

Shpenzimet për zgjidhje kontrate të njohura në 2014 në shumën 2,105 milionë Lekë, kanë të bëjnë me një pretendim të paraqitur në Gjykatën Tregtare të Britanisë së Madhe dhe Uellsit kundrejt shoqërisë mëmë nga BP Oil International Ltd (BPOI) në Shtator 2013, në lidhje me një mosmarrëveshje për përfundimin nga mëma të kontratës së shitjes së naftës bruto. Në dhjetor 2014, mëma filloi negociatat për zgjidhje të kontratës dhe në shkurt 2015, u arrit një zgjidhje e plotë dhe finale me BPOI për pagesën nga mëma ndaj BPOI. Në përputhje me rrethanat, shpenzimet për zgjidhjen e kontratës rezultuan në 2,105 milionë Lekë të njohura në 2014, të përbëra nga 1,740 milionë Lekë kosto dhe interesa të kësaj zgjidhjeje dhe 365 milionë Lekë tarifa ligjore dhe profesionale të lidhura me këtë pretendim. Mëma ia kaloi shpenzimin Degës në 2014 dhe kreu shlyerjen finale ndaj BPOI në 2015. Shpenzimet për zgjidhje kontratash të njohura në 2015 janë 48 milionë Lekë.

**13. PAGESA BAZUAR NË AKSIONE**

*(a) Opsionet*

Opsionet janë emtuar sipas planit të opsioneve të shoqërisë mëmë përfundimtare dhe Degës i është shpërndarë shpenzimi për opsionet e dhëna zyrtarëve dhe punonjësve të saj.

Çmimi mesatar i ponderuar i aksioneve në datën e ushtrimit të opsionit të ushtruar gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2015, ishte 3.35 CAD (2014: 6.09 CAD).

Vlera mesatare e ponderuar e tregut për opsionet e dhëna gjatë viteve të mbyllura më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, dhe supozimet për mesataret e ponderuara të përdorura në modelin Black-Scholes të vlerësimit të çmimit të opsionit paraqiten si më poshtë:

	<b>2015</b>	<b>2014</b>
Vlera e drejtë për opsion (CAD)	1.01	2.13
Norma e interesit pa rrezik (%)	0.62	1.54
Norma e humbjes (%)	5	5
Luhatshmëria (%)	57	54
Jetëgjatësia e prituri (vite)	5	5

Duke përdorur metodën e vlerës së drejtë për pagesat bazuar në aksione, për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015, Dega ka llogaritur pagesa bazuar në aksione prej 585 milionë Lekë (2014: 736 milionë Lekë) për opsionet që i janë dhënë zyrtarëve, drejtorëve, punonjësve dhe ofruesve të shërbimeve. Nga kjo shumë, 162 milionë Lekë (2014: 195 milionë Lekë) u njohën në fitim ose humbje dhe 423 milionë Lekë (2014: 541 milionë Lekë) u kapitalizuan.

*(b) Aksionet e kufizuara*

Aksionet e kufizuara janë emtuar sipas planit të shoqërisë mëmë përfundimtare dhe Degës i është shpërndarë shpenzimi për aksionet e kufizuara të dhëna zyrtarëve dhe punonjësve të saj.

Vlera e drejtë e tregut e aksioneve të kufizuara të dhëna më 31 dhjetor 2015 ishte 2.04 CAD për njësi aksioni (2014: zero) duke përdorur çmimin e mbylljes të aksioneve të zakonshme në datën e dhënies dhe duke supozuar një normë dështimi 5% (2014: 5%).

Duke përdorur metodën e vlerës së drejtë për pagesat bazuar në aksione, për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015, Dega ka llogaritur pagesa bazuar në aksione prej 160 milionë Lekë (2014: 18 milionë Lekë) për aksionet e kufizuara dhënë zyrtarëve, drejtorëve, punonjësve dhe ofruesve të shërbimeve. Nga kjo shumë, 50 milionë Lekë (2014: zero) u njohën në fitim ose humbje dhe 110 milionë Lekë (2014: 18 milionë Lekë) u kapitalizuan.



**Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri**  
**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

*(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)*

**14. KOSTO FINANCIARE NETO**

	<b>2015</b>	<b>2014</b>
<b>Të ardhura financiare</b>		
Të ardhura interesi	-	23,400
	<b>-</b>	<b>23,400</b>
<b>Kosto financiare</b>		
Shpenzime interesi mbi huatë bankare	(89,180)	(26,303)
Tarifa financimi	(25,192)	(22,101)
Rritja e detyrimit për nxjerrje nga përdorimi	(153,948)	(117,459)
Humbje neto nga kursi i këmbimit	(1,157,840)	(1,088,800)
	<b>(1,426,160)</b>	<b>(1,254,663)</b>
<b>Kosto financiare neto</b>	<b>(1,426,160)</b>	<b>(1,231,263)</b>

**15. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN**

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përbëhet si më poshtë:

	<b>2015</b>	<b>2014</b>
Shpenzimi i tatimit aktual mbi fitimin	-	-
Përfitimi/(shpenzimi) i tatimit të shtyrë mbi fitimin	2,723,507	(9,197,118)
<b>Totali</b>	<b>2,723,507</b>	<b>(9,197,118)</b>

Bazuar në Marëveshjen Hidrokarbure me Albpetrolin, tatimi mbi fitimin duhet të llogaritet sipas Ligjit Nr. 7811 datë 12 Prill 1994, i ndryshuar, “Mbi Miratimin me Ndryshime të Dekretit Nr. 782, datë 22.2.1994 – Mbi Sistemin Fiskal në Sektorin e Hidrokarbureve” dhe në përputhje me Licencën, sipas së cilës fitimi i tatuueshëm llogaritet duke zbritur të gjitha shpenzimet operative dhe kapitale të ndodhura gjatë periudhës së zhvillimit dhe prodhimit nga të ardhurat totale me një normë tatimore të zbatueshme prej 50%. Në përputhje me Marrëveshjen Hidrokarbure, shpenzimet e zbritshme të zhvillimit dhe prodhimit i raportohen mbi bazë tremujore AKBN-së në emër të Qeverisë Shqiptare. Shpenzimet e zbritshme duhet të vërtetohen nga AKBN dhe mund të jenë subjekt i kundërshtimeve me anë të kontrolleve që agjencia mund të kryejë brenda tre viteve nga data e raportimit.

Më poshtë paraqitet barazimi i tatimit mbi fitimin të llogaritur me normën tatimore në fuqi me shpenzimin e tatimit mbi fitimin:

	<b>2015</b>	<b>2014</b>
(Humbja)/fitimi para tatimit	<b>(4,711,536)</b>	<b>20,158,702</b>
Tatim mbi fitimin duke përdorur normën tatimore në fuqi brenda vendit 50%	(2,355,768)	10,079,351
Diferenca të përhershme	(358,670)	(882,233)
Të tjera	(9,069)	-
<b>(Përfitimi)/shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>	<b>(2,723,507)</b>	<b>9,197,118</b>

Dega beson se llogaritja e provizionit të tatimit mbi fitimin është e përshtatshme pavarësisht pasigurive të mjedisit tatimor shqiptar dhe legjislacionit në fuqi si dhe beson që çdo kontroll i ardhshëm tatimor nuk do të ketë ndikim të rëndësishëm në pozicionin financiar të Degës, rezultatet e aktivitetit apo në flukset monetare. Megjithatë, për shkak të natyrës së ligjit mbi tatimin mbi fitimin, udhëzimeve dhe praktikave të lidhura me të, nuk është e mundur të ketë siguri që pozicioni aktual ligjor i tatimit mbi fitimin nuk do të kundërshtohet nga autoritetet tatimore.

**Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri**  
**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

*(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)*

**15. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN (VAZHDIM)**

Aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra lidhen me sa më poshtë:

	31 dhjetor 2015		
	Aktivitet	Detyrimet	Neto
AAM dhe K&V	-	(64,515,752)	<b>(64,515,752)</b>
Kosto të zbritshme të akumuluar	16,002,438	-	<b>16,002,438</b>
Pagesa bazuar në aksione	2,551,913	-	<b>2,551,913</b>
Detyrim për nxjerrje nga përdorimi	1,708,102	-	<b>1,708,102</b>
<b>Aktivitet/(detyrimi) neto i tatimit të shtyrë</b>	<b>20,262,453</b>	<b>(64,515,752)</b>	<b>(44,253,299)</b>

	31 dhjetor 2014		
	Aktivitet	Detyrimet	Neto
AAM dhe K&V	-	(57,454,428)	<b>(57,454,428)</b>
Kosto të zbritshme të akumuluar	10,818,945	-	<b>10,818,945</b>
Pagesa bazuar në aksione	2,185,337	-	<b>2,185,337</b>
Detyrim për nxjerrje nga përdorimi	1,420,383	-	<b>1,420,383</b>
<b>Aktivitet/(detyrimi) neto i tatimit të shtyrë</b>	<b>14,424,665</b>	<b>(57,454,428)</b>	<b>(43,029,763)</b>

Lëvizjet në diferencat e përkohshme gjatë vitit janë si më poshtë:

	Gjendja në çelje	Njohur në fitim ose humbje	Diferenca këmbimi	Gjendja në mbyllje
<b>31 dhjetor 2015</b>				
AAM dhe K&V	(57,454,428)	(1,798,468)	(5,262,856)	(64,515,752)
Kosto të zbritshme të akumuluar	10,818,945	4,197,680	985,813	16,002,438
Pagesa bazuar në aksione	2,185,337	166,530	200,046	2,551,913
Detyrim për nxjerrje nga përdorimi	1,420,383	157,765	129,954	1,708,102
<b>Totali</b>	<b>(43,029,763)</b>	<b>2,723,507</b>	<b>(3,947,043)</b>	<b>(44,253,299)</b>
<b>31 dhjetor 2014</b>				
AAM dhe K&V	(41,755,373)	(9,353,698)	(6,345,357)	(57,454,428)
Kosto të zbritshme të akumuluar	9,714,063	(155,774)	1,260,656	10,818,945
Pagesa bazuar në aksione	1,734,889	203,883	246,565	2,185,337
Detyrim për nxjerrje nga përdorimi	1,150,829	108,471	161,083	1,420,383
<b>Totali</b>	<b>(29,155,592)</b>	<b>(9,197,118)</b>	<b>(4,677,053)</b>	<b>(43,029,763)</b>

Detyrimi tatimor i shtyrë i Degës rezulton nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerave tatimore të aktiveve dhe detyrimeve. Plani vjetor i Punës dhe Buxheti i paraqitet dhe aprovohet çdo vit nga AKBN dhe të gjitha kostot e përfshira në kostot e zbritshme të akumuluar janë subjekt i kontrolleve rutinë të vazhdueshme.

Dega ka marrë një raport kontrolli për shpenzimet e 2011 nga AKBN me gjetje që mund të rezultojnë në 38,114 milionë Lekë pakësim të kostove të zbritshme të akumuluar dhe në një pozicion të mundshëm të tatueshëm. Më 27 korrik 2015, Degës iu lëshua një raport kontrolli i rishikuar nga AKBN ku kostot e kundërshtuara u ulën në 31,573 milionë Lekë. Kontrollat e tjera rutinë kanë pranuar kostot e Degës të përfshira në kostot e zbritshme të akumuluar dhe, bazuar në këto kontrolle dhe miratimin e planit nga AKBN, Dega dhe shoqëria mëmë përfundimtare aktualisht po mbrojnë të gjitha kostot duke siguruar dokumentacionet e nevojshme justifikuese.

Pas 31 dhjetorit 2015, Dega ka firmosur një marrëveshje formale me AKBN dhe Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë për të angazhuar një auditues ndërkombëtar si palë e tretë për të rishikuar e vlerësuar nëse kostot janë të çertifikueshme si kosto hidrokarbure sipas Marrëveshjes Hidrokarbure dhe sipas Licencës. Puna e audituesit të pavarur nuk ka përfunduar ende.

**Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri**  
**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

*(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)*

**16. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTË**

	<b>2015</b>	<b>2014</b>
Mjete monetare në bankë	33,296	559,147
Mjete monetare në arkë	1,171	2,448
	<b>34,467</b>	<b>561,595</b>

**17. MJETE MONETARE TË NGURTËSUARA**

	<b>2015</b>	<b>2014</b>
Garanci bankare për Bllokun “F”	628,950	576,150
Garanci bankare për vlerësimet tatimore	1,090,219	-
	<b>1,719,169</b>	<b>576,150</b>

Më 31 dhjetor 2015, garancitë bankare për vlerësimet tatimore në shumën 1,090 milionë Lekë (2014: zero) përfshijnë një garanci bankare prej 990 milionë Lekë për një çështje me Autoritetet Tatimore (shiko shënimin 27.b.iv) dhe garanci të tjera bankare në shumën 100 milionë Lekë për çështje me Autoritetet Vendore.

**18. SHUMA DHE SHPENZIME TË PARAPAGUARA**

	<b>2015</b>	<b>2014</b>
Taksa të parapaguara importi dhe të tjera	5,102,255	5,407,621
Tatim i parapaguar mbi fitimin	1,674,313	-
Paradhënie furnitorëve	517,298	776,285
Shpenzime të parapaguara	949,486	994,012
<b>Totali</b>	<b>8,243,352</b>	<b>7,177,918</b>

Taksa të parapaguara importi dhe të tjera prej 5,102 milionë Lekë (2014: 5,408 milionë Lekë) përfshijnë kryesisht parapagime të Degës për taksa karboni dhe qarkullimi mbi importet e holluesit në shumën 4,777 milionë Lekë (2014: 4,855 milionë Lekë) dhe akcizë të parapaguar në shumën 171 milionë Lekë (2014: 157 milionë Lekë). Gjatë 2015, janë arkëtuar afërsisht 1,296 milionë Lekë taksa të karbonit dhe qarkullimi të paguara me parë (referohu gjithashtu 27.b.ii).

Tatimi i parapaguar mbi fitimin prej 1,674 milionë Lekë ka të bëjë me vlerësimin tatimor të marrë nga Dega prej 7,520 milionë Lekë (shih gjithashtu shënimin 15) në lidhje me kontrollin e AKBN në 2011 për koston e zbritshme. Shuma prej 1,674 milionë Lekë u regjistrua si parapagim për këtë vlerësim tatimor ndërsa shuma e mbetur është rënë dakord t’u paguhet autoriteteve tatimore shqiptare me pagesa mujore prej 486 milionë Lekë gjatë 2016 (shih gjithashtu 27.b.i).

Më 31 dhjetor 2015, totali i taksave të parapaguara të importit dhe të tjera si dhe tatimi i parapaguar mbi fitimin konsiderohen si të rikuperueshme. Dega pret të mbledhë shumën e plotë të paguar dhe e ka klasifikuar këtë shumë si afatshkurtër.

**19. TË ARKËTUESHMET TREGTARE DHE TË TJERA**

	<b>2015</b>	<b>2014</b>
Të arkëtueshme tregtare	1,285,684	5,552,603
TVSH	4,817,173	3,458,428
<b>Totali</b>	<b>6,102,857</b>	<b>9,011,031</b>

**20. TË ARKËTUESHME DHE TË PAGUESHME ME PALËT E LIDHURA**

*(a) Të arkëtueshme nga palët e lidhura*

Më 31 dhjetor 2015, të arkëtueshmet nga palët e lidhura rezultojnë 85 milionë Lekë (2014: 78 milionë Lekë) që përbëjnë shumën e arkëtueshme nga Sherwood International Petroleum Ltd – Dega në Shqipëri (SIPL) dhe përfshijnë shpërndarjen e disa kostove të kryera nga Dega për llogari të SIPL.

**Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri**  
**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

**20. TË ARKËTUESHME DHE TË PAGUESHME ME PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)**

(b) Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Më 31 dhjetor 2015, shumat e pagueshme ndaj palëve të lidhura prej 37,911 milionë Lekë (2014: 30,102 milionë Lekë) përfaqëson financim pa interes të marrë nga shoqëritë mëmë të ndërmjetme dhe përfundimtare (“Palët Financuese”) për kapital qarkullues dhe qëllime investimi. Kjo shumë përfshin ngarkimin e disa kostove të kryera nga shoqëria mëmë përfundimtare për llogari të Degës. Shuma gjendje është e pagueshme nga Dega me lëshimin e një urdhri pagese nga Palët Financuese, i cili do të përmbajë kushtet dhe formën e pagesës. Në çdo rast Dega ka të drejtën e pagesës më të hershme, në një ose disa këste, para lëshimit të urdhrit përkatës të pagesës nga Palët Financuese.

**21. INVENTARË**

	<b>2015</b>	<b>2014</b>
Nafta bruto	527,825	953,634
Hollues	-	133,156
Karburant dhe të tjera	39,905	69,355
<b>Totali</b>	<b>567,730</b>	<b>1,156,145</b>

**22. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE**

	<b>Aktive naftë</b>	<b>Pajisje, mobilje dhe instalime</b>	<b>Totali</b>
<i>Kosto</i>			
<b>Më 1 janar 2014</b>	109,077,350	1,214,210	<b>110,291,560</b>
Shtesa	30,512,897	244,807	<b>30,757,704</b>
Diferenca këmbimi	17,137,786	182,004	<b>17,319,790</b>
<b>Më 31 dhjetor 2014</b>	<b>156,728,033</b>	<b>1,641,021</b>	<b>158,369,054</b>
Shtesa	18,485,753	90,856	18,576,609
Diferenca këmbimi	14,338,047	150,265	14,488,312
<b>Më 31 dhjetor 2015</b>	<b>189,551,833</b>	<b>1,882,142</b>	<b>191,433,975</b>
<i>Amortizimi dhe harxhimi i akumuluar</i>			
<b>Më 1 janar 2014</b>	<b>(27,171,075)</b>	<b>(515,790)</b>	<b>(27,686,865)</b>
Shpenzimi i vitit	(12,080,423)	(160,286)	(12,240,709)
Diferenca këmbimi	(4,683,086)	(82,788)	(4,765,874)
<b>Më 31 dhjetor 2014</b>	<b>(43,934,584)</b>	<b>(758,864)</b>	<b>(44,693,448)</b>
Shpenzimi i vitit	(14,791,039)	(201,888)	(14,992,927)
Diferenca këmbimi	(4,006,326)	(68,977)	(4,075,303)
<b>Më 31 dhjetor 2015</b>	<b>(62,731,949)</b>	<b>(1,029,728)</b>	<b>(63,761,678)</b>
<i>Vlera e mbartur</i>			
<b>Më 1 janar 2014</b>	<b>81,906,274</b>	<b>698,420</b>	<b>82,604,694</b>
<b>Më 31 dhjetor 2014</b>	<b>112,793,449</b>	<b>882,157</b>	<b>113,675,606</b>
<b>Më 31 dhjetor 2015</b>	<b>126,819,884</b>	<b>852,414</b>	<b>127,672,298</b>

Baza e llogaritjes së shpenzimit të harxhimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 përfshin 239,614 milionë Lekë (2014: 230,898 milionë Lekë) për kostot e ardhshme të vlerësuara të zhvillimit që lidhen me rezervat e vërtetuara dhe të mundshme në Shqipëri.

**Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri**  
**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

*(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)*

**22. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (VAZHDIM)**

Dega ka kapitalizuar shpenzimet e përgjithshme administrative dhe pagesa të bazuara në aksione për shumën totale 787 milionë Lekë gjatë vitit të mbyllur 31 dhjetor 2015 (2014: 780 milionë Lekë) dhe që lidhen drejtpërdrejt me aktivitetet e zhvillimit dhe prodhimit. Të përfshira në Aktive Afatgjata materiale më 31 dhjetor 2015 janë dhe pajisjet në fushën naftëmbajtëse prej 5,002 milionë Lekë (2014: 4,772 milionë Lekë) për t'u përdorur në programe të ardhshme të shpimit, riaktivizimit dhe të infrastrukturës. Për vitet 31 dhjetor 2015 dhe 2014, nuk kishte zhvlerësim të aktiveve të naftës.

Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, të gjitha aktivet e Degës janë lënë peng si garanci për huatë e marra nga shoqëria mëmë përfundimtare.

**23. AKTIVET E KËRKIMIT DHE VLERËSIMIT**

	<b>Totali</b>
<b>Gjendje më 31 dhjetor 2013</b>	<b>698,312</b>
Shtesat	180,332
Diferenca këmbimi	108,328
<b>Gjendje më 31 dhjetor 2014</b>	<b>986,972</b>
Shtesat	28,574
Diferenca këmbimi	90,411
<b>Gjendje më 31 dhjetor 2015</b>	<b>1,105,957</b>

Aktivitetet e kërkimit dhe vlerësimit konsistojnë në projektet e kërkimit të Degës të cilat janë në pritje të përcaktimit të rezervave të vërtetuara dhe të mundshme. Për vitet e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, nuk ka patur zhvlerësime të aktiveve të kërkimit dhe vlerësimit.

**24. HUATË**

Huatë më 31 dhjetor 2015 në shumën 2,120 milionë Lekë (2014: zero) konsistojnë në një kredi dyvjeçare, me interes sipas Normës së London Inter Bank Offer (Libor) plus 3.5% që u maturua më 31 mars 2016 dhe është në proces rinovimi.

**25. TË PAGUESHME DHE DETYRIME TË PËRLLOGARITURA**

	<b>2015</b>	<b>2014</b>
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	2,582,380	4,302,516
Detyrime të përlogaritura	1,763,434	2,817,618
<b>Totali</b>	<b>4,345,814</b>	<b>7,120,134</b>

**26. DETYRIM PËR NXJERRJE NGA PËRDORIMI**

	<b>2015</b>	<b>2014</b>
<b>Gjendje më 1 janar</b>	<b>2,840,738</b>	<b>2,301,657</b>
Shtesa	161,671	99,459
Rritje/(ulje) në vlerësimin e shpenzimeve të restaurimit	73,309	(85,122)
Diferenca këmbimi	186,599	407,285
Rritje e detyrimit për nxjerrje nga përdorimi	153,948	117,459
<b>Gjendje më 31 dhjetor</b>	<b>3,416,265</b>	<b>2,840,738</b>

Detyrimi për nxjerrje nga përdorimi i Degës rezulton nga interesat e saj pronësore mbi aktive naftë që përfshijnë pusët dhe sistemet e mbledhjes. Detyrimi total për nxjerrje nga përdorimi është vlerësuar bazuar në interesat pronësore neto mbi gjithë pusët dhe pajisjet, kostot e vlerësuar për restaurimin dhe braktisjen e këtyre puseve dhe pajisjeve dhe, kohën e vlerësuar të ndodhjes së kostove në vitet e ardhshme. Dega ka vlerësuar shumën totale të paskontuar të nevojshme për të shlyer detyrimin për nxjerrje nga përdorimi më 31 dhjetor 2015 në një total prej 8,809 milionë Lekë (2014: 7,838 milionë Lekë). Ky detyrim do të shlyhet në fund të licencës 25 vjeçare të Degës për Marëveshjen e Patos-Marinzës, nga e cila kanë mbetur dhe 15 vite. Detyrimi më 31 dhjetor 2015 është skontuar me një normë interesi pa risk 7% (2014: 7%).

**Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri**  
**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

*(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)*

**27. ANGAZHIMET DHE DETYRIMET E KUSHTËZUARA**

**(a) Angazhime të qerasë operative**

Angazhimet minimale të Degës për qiratë operative më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 janë si më poshtë:

	<b>2015</b>	<b>2014</b>
Më pak se një vit	55,766	75,360
Ndërmjet një dhe pesë vite	128,602	153,256
Më shumë se pesë vite	-	18,552
<b>Totali</b>	<b>184,368</b>	<b>247,168</b>

**(b) Detyrimet e kushtëzuara**

*Mosmarrëveshjet me AKBN dhe Autoritetet Tatimore*

(i) Në vijim të një kontrolli të kryer nga AKBN dhe vlerësimit që AKBN ka bërë për të korrigjuar kostot që mund të mos zbriten për qëllime të fitimit të tatueshëm, autoritetet tatimore kanë rillogaritur vlerat e kostove të zbritshme për vitin 2011. Bazuar në këto rillogaritje, autoritetet tatimore kanë vlerësuar detyrimin për tatimin mbi fitimin të Degës në shumën 7,520 milionë Lekë.

Dega ka ndjekur procedurat për të apeluar rezultatet e kontrollit të kryer nga AKBN duke ndjekur hapat procedurale që përcaktohen në Marrëveshjen Hidrokarbure. Ligji shqiptar mbi “Procedurat Tatimore” nuk ka asnjë dispozitë që të rregullojë kontrollin e kryer nga AKBN, ndërsa fitimi i tatueshëm i Degës rregullohet nga ligji fiskal mbi aktivitetet hidrokarbure. AKBN ka autoritetin për të certifikuar njohjen e kostove për qëllime të fitimit të tatueshëm.

Aktualisht, një ekspert i pavarur është caktuar për të rishikuar kostot e 2011 për zbritshmërinë për qëllime të fitimit të tatueshëm. Rezultati përfundimtar i vlerësimit tatimor do të varen nga raporti dhe vlerësimet e ekspertit të jashtëm të pavarur.

*Mosmarrëveshje me autoritetet tatimore*

(ii) Dega ka paguar taksa karboni dhe qarkullimi mbi gazoilin dhe karburantin e importuar gjatë periudhës maj 2012 deri në janar 2014 dhe ka kërkuar rimbursimin e këtyre taksave të paguara në import dhe më pas ka pretenduar rimbursimin e shumës afërsisht 2,497 milionë Lekë nga Gjykata Administrative e Durrësit. Gjykata Administrative refuzoi pretendimin e Degës dhe më pas, kjo e fundit e ka apeluar më tej çështjen në Gjykatën Administrative të Apelit. Aktualisht, nuk është marrë ende një vendim nga Gjykata e Apelit dhe Dega po pret për seancën dëgjimore. Shuma prej 2,497 milionë Lekë është e përfshirë në taksat e parapaguara të importit dhe të tjera dhe drejtimi i Degës pret ta mbledhë këtë shumë brenda vitit 2016. Bazuar në këshilltarët e jashtëm ligjor që përfaqësojnë Degën në procesin apelimit, Drejtimi beson se rezultati final do të jetë rimbursimi i taksave të karbonit dhe qarkullimit. Përfshirja nga taksat e importit parashikohet nga kuadri ligjor tatimor mbi aktivitetet hidrokarbure të cilit Dega i nënshtrohet dhe, sipas përkufizimeve të Kodit Doganor, taksat e karbonit dhe qarkullimit do të konsideroheshin si taksa importi.

(iii) Dega ka marrë një njoftim vlerësimi tatimor për detyrimin mbi akcizën për gazoilin dhe karburantin e importuar në shumën prej afërsisht 2,407 milionë Lekë të cilin Dega e ka apeluar. Dega e ka fituar çështjen në Gjykatën Administrative dhe autoritetet tatimore e kanë apeluar këtë vendim në Gjykatën e Apelit ku kjo e fundit ka nxjerrë një vendim në favor të Degës duke anuluar vlerësimet e bëra. Autoritetet tatimore e kanë çuar çështjen më tej në Gjykatën e Lartë, e cila është instanca e fundit e procesit të apelimit dhe aktualisht të dy palët janë në pritje të seancës dëgjimore.

(iv) Ne vijim te një kontrolli tatimor nga inspektorët tatimorë për Tatimpaguesit e Mëdhenj, i cili është kryer për rimbursimin e TVSH-së së kërkuar nga Dega për periudhën tetor 2014 deri në janar 2015, autoritetet tatimore kanë vlerësuar detyrime shtesë tatimore në një shumë prej afërsisht 1,298 milionë Lekë. Vlerësimi tatimor përfshin kryesisht vlerësimin e TVSH dhe gjithashtu të tatimit në burim dhe rentës minerare. Dega e ka apeluar vendimin e njësisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj në Drejtorinë Tatimore të Apelit më 25 shtator 2015. Drejtoria Tatimore e Apelit vendosi për të lënë në fuqi pjesën më të madhe të detyrimeve tatimore të vlerësuar. Pas vendimit të Drejtorisë Tatimore të Apelit, Dega ka ngritur padi në Gjykatën Administrative dhe aktualisht po pret për seancën dëgjimore.

**Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri**  
**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

*(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)*

**27. ANGAZHIMET DHE DETYRIMET E KUSHTËZUARA (VAZHDIM)**

**(b) Detyrimet e kushtëzuara (vazhdim)**

*Çështje gjyqësore të tjera*

Dega është subjekt i pretendimeve dhe çështjeve të tjera gjyqësore që vijnë nga veprimtaria e zakonshme e biznesit. Drejtimi beson që këto në të ardhmen nuk do të kenë ndonjë ndikim negativ material në pozicionin financiar të Degës, rezultatet e operacioneve ose flukseve monetare.

**28. PALËT E LIDHURA**

Dega ka marrëdhënie si palë e lidhur me shoqëritë mëmë përfundimtare dhe të ndërmjetme, shoqëri të tjera brenda Grupit dhe stafin kryesor drejtues. Një përmbledhje e balancave dhe transaksioneve me palët e lidhura paraqitet si më poshtë:

	<u>2015</u>	<u>2014</u>
<b>Të arkëtueshme</b>		
Të arkëtueshme të tjera nga SIPL (shënimi 20)	85,369	78,203
Të arkëtueshme tregtare nga SIPL	23,599	-
<b>Detyrime</b>		
Të pagueshme ndaj shoqërive mëmë përfundimtare dhe të ndërmjetme (shënimi 20)	37,910,829	30,101,828
<b>Shitja e mallrave</b>		
Shitja e materialeve	23,599	-
<b>Shpenzime</b>		
Personeli dhe kosto të lidhura me të	925,901	937,552
Shpenzime për zgjidhje kontrate	48,495	364,758
Pagesa bazuar në aksione	767,250	736,336
Shpenzime të tjera	219,783	904,005
<b>Kompensimi i drejtuesve kryesor</b>		
Paga	202	191
Përfitime afatshkurtër	77	70
Përfitime nga zgjidhja e kontratave	36	-
Pagesa bazuar në aksione	<u>277</u>	<u>253</u>

**29. NGJARJET VIJUESE**

Drejtimi i Degës nuk është në dijeni për ndonjë ngjarje vijuese që do të kërkonte rregullime ose shënime shtesë në pasqyrat financiare, përveç se çfarë është shpjeguar në shënimin 1.

### **30. KORRIGJIMI I GABIMEVE**

A. Gjatë 2015, Dega ka rishikuar treguesit primarë dhe të tjerë në përcaktimin e monedhës funksionale duke dalë në përfundimin që është USD monedha funksionale e Degës, në vend të Lekut të konsideruar në pasqyrat financiare ligjore për qëllime të përgjithshme të Degës në 2014. Sipas SNK 21 monedha funksionale e një njësie ekonomike është monedha e mjedisit primar ekonomik në të cilin ajo vepron. Megjithatë, në përcaktimin e monedhës funksionale, gjatë 2015 Dega theksoi që USD është monedha që përcakton çmimin e transaksioneve që ajo ndërmerr, duke mos u nisur nga monedhat me të cilat transaksionet emërtohen. Dega eksporton kryesisht naftë bruto drejt klientëve ndërkombëtare dhe çmimi përkatës është përcaktuar në USD pasi bazohet në çmimin e naftës Brent rregulluar për ndryshimin sipas cilësisë. Gjithashtu shitjet brenda vendit nuk janë shumë të ndryshme nga eksportet dhe nuk përcaktohen nga konkurrenca dhe rregullat lokale, por nga konkurrenca botërore dhe forcat globale të kërkesës dhe ofertës në tregjet ndërkombëtare të naftës. Faktorë të tjerë që u konsideruan kanë lidhje me pjesën e prodhimit të nxjerrë në natyrë që vlerësohet në mënyrë të ngjashme me shitjet e tjera, pra bazuar në çmimin e naftës Brent. Për më tepër, kostot kryesore operative të Degës lidhen me nxjerrjen e naftës bruto, si për shembull shërbimet e pusit, kostot e personelit, energjia, transporti etj.), që kryhen nga furnitorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë dhe pjesa më e madhe e shpenzimeve përkatëse janë përcaktuar në USD, e cila është monedha që ndikon më shumë punën, materialet dhe kostot e tjera e ofrimit të shërbimeve duke patur në konsideratë dhe karakterin global të industrisë.

Dega ka zbatuar në mënyrë të qëndrueshme përdorimin e USD si monedhë funksionale në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare dhe efektet përkatëse janë përmbledhur në tabelën më poshtë:



**Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri**  
**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

*(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)*

**30. KORRIGJIMI I GABIMEVE (VAZHDIM)**

(i) *Pasqyra e pozicionit financiar*

Shënime	31 dhjetor 2014					
	Raportuar më parë	Rregullime	Riklasifikime	Efekti i ndryshimit në monedhën funksionale	Riparaqitur	
<b>Aktivët</b>						
Mjete monetare e ekuivalentë	561,574	-	-	21	561,595	
Mjete monetare të ngurtësuara	E	-	529,474	46,676	576,150	
Shuma dhe shpenzime të parapaguara	6,765,321	-	-	412,597	7,177,918	
Të arkëtueshme tregtare e të tjera	F,I	7,416,446	1,361,320	(78,203)	9,011,031	
Të arkëtueshme nga palët e lidhura		-	78,203	-	78,203	
Inventarë	989,911	-	-	166,234	1,156,145	
Aktive afatgjata materiale	B	89,726,132	5,791,441	4,000,470	113,675,606	
Aktive kërkimi dhe vlerësimi	B	4,619,562	-	(4,000,470)	986,972	
<b>Totali aktiveve</b>		<b>110,078,946</b>	<b>7,152,761</b>	<b>529,474</b>	<b>15,462,439</b>	<b>133,223,620</b>
<b>Detyrime</b>						
Të pagueshme ndaj palëve e lidhura	C, E, D	34,654,434	398,480	(6,014,947)	1,063,861	30,101,828
Të pagueshme dhe detyrime të përlogaritura	C	4,481,634	1,901,295	-	737,205	7,120,134
Detyrim për nxjerrje nga përdorimi		2,534,647	-	-	306,091	2,840,738
Detyrim për tatimin e shtyrë	G	38,936,064	4,093,699	-	-	43,029,763
<b>Totali detyrimeve</b>		<b>80,606,779</b>	<b>6,393,474</b>	<b>(6,014,947)</b>	<b>2,107,157</b>	<b>83,092,463</b>
<b>Kapitali</b>						
Kontribut shtesë		-	-	6,544,421	-	6,544,421
Rezervë përktimi		-	-	-	5,052,822	5,052,822
Fitim i pashpërndarë	B,C,F,G	29,472,167	759,287	-	8,302,460	38,533,914
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>29,472,167</b>	<b>759,287</b>	<b>6,544,421</b>	<b>13,355,282</b>	<b>50,131,157</b>
<b>Totali detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>110,078,946</b>	<b>3,428,374</b>	<b>529,474</b>	<b>15,384,236</b>	<b>133,223,620</b>

**Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri**  
**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

*(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)*

**30. KORRIGJIMI I GABIMEVE (VAZHDIM)**

(i) *Pasqyra e pozicionit financiar (vazhdim)*

Shënime	1 janar 2014					
	Raportuar më parë	Rregullime	Riklasifikime	Efekti i ndryshimit në monedhën funksionale	Riparaqitur	
<b>Aktivët</b>						
Mjete monetare e ekuivalentë	2,322,055	-	-	129	2,322,184	
Mjete monetare të ngurtësuara	E	-	-	(29,029)	724,137	
Shuma dhe shpenzime të parapaguara	5,755,461	-	(1,227,337)	(2,474)	4,525,650	
Të arkëtueshme tregtare e të tjera	H, I,	6,258,483	-	1,227,337	(23,550)	7,462,270
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	I	-	69,129	-	-	69,129
Inventarë		3,958,353	-	-	(85,111)	3,873,242
Aktive afatgjata materiale	B	72,683,847	3,880,633	4,678,569	1,364,156	82,607,204
Aktive kërkimi dhe vlerësimi	B	5,100,860	-	(4,678,569)	276,021	698,312
<b>Totali aktiveve</b>		<b>96,079,059</b>	<b>3,949,762</b>	<b>753,166</b>	<b>1,500,142</b>	<b>102,282,128</b>
<b>Detyrime</b>						
Hua		1,527,885	-	-	-	1,527,885
Të pagueshme ndaj palëve e lidhura	C, E, D	38,029,828	-	(5,036,862)	(741,996)	32,250,970
Të pagueshme dhe detyrime të përlogaritura		3,573,171	-	-	472,249	4,045,420
Detyrim për nxjerrje nga përdorimi		2,316,452	-	-	(14,795)	2,301,657
Detyrim për tatimin e shtyrë	G	25,638,336	3,517,256	-	-	29,155,592
<b>Totali detyrimeve</b>		<b>71,085,672</b>	<b>3,517,256</b>	<b>(5,036,862)</b>	<b>(284,543)</b>	<b>69,281,524</b>
<b>Kapitali</b>						
Kontribut shtesë		-	-	5,790,028	-	5,790,028
Rezervë përkthimi		-	-	-	(350,357)	(350,357)
Fitim i pashpërndare	B,C,F,G	24,993,386	432,506	-	2,135,041	27,560,933
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>24,993,386</b>	<b>432,506</b>	<b>5,790,028</b>	<b>1,784,684</b>	<b>33,000,604</b>
<b>Totali detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>96,079,058</b>	<b>3,949,762</b>	<b>753,166</b>	<b>1,500,142</b>	<b>102,282,128</b>

**Bankers Petroleum Albania Ltd – Dega në Shqipëri**  
**Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

*(Shumat janë në mijë Lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)*

**30. KORRIGJIMI I GABIMEVE(VAZHDIME)**

*(ii) Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse*

	Shënime	Raportuar më parë	Rregullime	Riklasifikime	Efekti i ndryshimit në monedhën funksionale	Riparaqitur
Të ardhura	J	54,378,640	-	5,580,351	1,538,739	61,497,730
Pagesa për të drejta minerare		(9,037,320)	-	-	(14,280)	(9,051,600)
Shpenzime operative	B	(11,928,930)	1,910,808	-	2,101	(10,016,021)
Shpenzime shitje dhe transporti	J	-	-	(5,580,351)	(691,743)	(6,272,094)
Shpenzime të përgjithshme administrative	D	(1,638,752)	-	198,905	2,142	(1,437,705)
Shpenzime për zgjidhje kontrate	C	-	(2,105,183)	-	-	(2,105,183)
Harxhimi dhe amortizimi		(12,337,358)	-	-	96,650	(12,240,708)
Pagesa bazuar në aksione	D	-	-	(198,905)	4,158	(194,747)
Rimarrje zhvlerësimi	F	-	1,227,900	-	(17,607)	1,210,293
Kosto financiare neto	F	(1,659,769)	230,460	-	198,046	(1,231,263)
Shpenzimi i tatim fitimit	G	(13,297,458)	4,093,699	6,641	-	(9,197,118)
<b>Humbja</b>		<b>4,479,053</b>	<b>5,357,684</b>	<b>6,641</b>	<b>1,118,206</b>	<b>10,961,584</b>
Diferenca përkthimi		-	-	-	5,414,575	5,414,575
<b>Të ardhurat e tjera përmbledhëse</b>		<b>4,479,053</b>	<b>5,357,684</b>	<b>6,641</b>	<b>6,532,781</b>	<b>16,376,159</b>

**30. KORRIGJIMI I GABIMEVE (VAZHDIM)**

- B. Gjatë 2015, Dega zbuloi që disa kosto të kapitalizuara i janë ngarkuar gabimisht shpenzimeve në pasqyrat financiare që në vitin 2008, kur SNRF janë zbatuar për herë të parë në pasqyrat financiare ligjore për qëllime të përgjithshme. Si pasojë, kostot e kapitalizuara kanë qenë paraqitur me vlerë më të ulët. Përveç kësaj, disa zëra të aktiveve afatgjata materiale janë klasifikuar gabimisht si aktive për kërkim dhe zhvillim. Gabimet janë korrigjuar duke riparaqitur secilin prej zërave të prekur në pasqyrat financiare për periudhat e mëparshme.
- C. Gjatë 2015, Dega zbuloi se një pretendim për zgjidhje kontrate i paguar gjatë 2015 lidhur me një mosmarrëveshje, gabimisht nuk është kontabilizuar në pasqyrat financiare ligjore për qëllime të përgjithshme të vitit 2014, duke qenë se në kohën e miratimit të tyre ekzistonte një detyrim ligjor që mund të vlerësohej në mënyrë të besueshme dhe me një dalje të mundshme të flukseve monetare përkatëse. Si pasojë, në 2014, të pagueshmet ndaj palëve të lidhura, të pagueshmet dhe detyrimet e përllogaritura dhe shpenzimet për zgjidhje kontrate kanë qenë paraqitur me vlerë më të ulët. Gabimi është korrigjuar duke riparaqitur secilin prej zërave të prekur në pasqyrat financiare për periudhën e mëparshme.
- D. Gjatë 2015, Dega zbuloi që pagesat bazuar në aksione në lidhje me opsionet dhe aksionet e kufizuara dhënë si shpërblim punonjësve, drejtorëve dhe ofruesve të shërbimeve për aktivitetin e segmentit Shqiptar kanë qenë paraqitur gabimisht si të pagueshme ndaj palëve të lidhura dhe jo si një zë më vete në kapitalin/fondet neto të Degës. Si pasojë, të pagueshmet ndaj palëve të lidhura kanë qenë paraqitur me vlerë më të lartë dhe kontributi shtesë ka qenë paraqitur me vlerë më të ulët. Për më tepër, pagesat bazuar në aksione në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse janë paraqitur si pjesë e shpenzimeve të përgjithshme administrative në vend që të paraqiteshin veçmas. Gabimi është korrigjuar duke riparaqitur secilin prej zërave të prekur në pasqyrat financiare për periudhat e mëparshme.
- E. Gjatë 2015, Dega zbuloi që mjetet monetare të ngurtësuara kanë qenë paraqitur gabimisht në pasqyrat financiare ligjore për qëllime të përgjithshëm të 2014 si një kundër llogari e të pagueshmeve ndaj palëve të lidhura. Si pasojë, mjetet monetare të ngurtësuara dhe të pagueshmet ndaj palëve të lidhura kanë qenë paraqitur me vlerë më të ulët. Gabimi është korrigjuar duke riparaqitur secilin prej zërave të prekur në pasqyrat financiare për periudhën e mëparshme.
- F. Gjatë 2015, Dega zbuloi që zbritjet nga zhvlerësimi i të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera ishin njohur më tepër në pasqyrat financiare ligjore për qëllime të përgjithshme të vitit 2014 krahasuar me pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë mëmë. Si pasojë, të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera kanë qenë paraqitur me vlerë më të ulët dhe shpenzimi i zhvlerësimit ka qenë paraqitur me vlerë më të lartë. Gabimi është korrigjuar duke riparaqitur secilin prej zërave të prekur në pasqyrat financiare për periudhën e mëparshme.
- G. Gjatë 2015, Dega zbuloi që tatimi i shtyrë për vitet 2014 dhe 2013 ka qenë llogaritur gabim. Gabimet janë korrigjuar duke riparaqitur secilin prej zërave të prekur në pasqyrat financiare për periudhat e mëparshme.
- H. Gjatë 2015, Dega zbuloi që të arkëtueshmet nga TVSH në 2013 kanë qenë klasifikuar gabimisht si shuma dhe shpenzime të parapaguara, në vend që të klasifikoheshin si të arkëtueshme tregtare dhe të tjera. Gabimi është korrigjuar duke riparaqitur secilin prej zërave të prekur në pasqyrat financiare për periudhën e mëparshme.
- I. Gjatë 2015, Dega zbuloi që të arkëtueshmet ndaj palëve të lidhura në 2014 dhe 2013 kanë qenë klasifikuar gabimisht si të arkëtueshme tregtare dhe të tjera të arkëtueshme, në vend që të paraqiteshin më vete. Gabimi është korrigjuar duke riparaqitur secilin prej zërave të prekur në pasqyrat financiare për periudhat e mëparshme.
- J. Gjatë 2015, Dega zbuloi që shpenzimet e shitjes dhe transportit në 2014 kanë qenë zbritur gabimisht nga të ardhurat neto në vend që të prezantoheshin veçmas në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave përmbledhëse. Gabimi është korrigjuar duke riparaqitur secilin prej zërave të prekur në pasqyrat financiare për periudhën e mëparshme.